

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7365 E diel 26 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Fjalimi

Ditës

Nga ILIR META



Edashur zonja Holhmeier, 3 vite më parë, kur isha në detyrën e kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë m'u dha mundësia e shkëlqyer që të organizoja një ceremoni ...
Vijon në faqen 21

Nderim për vizionin e Shtrausit, një stacion që ne e humbëm

Reportazhi

Ditës

Nga "ZËRI I AMERIKËS"



Dje ishte Dita Ndërkombëtare e Eliminimit të Dhunës kundër Grave. Në Shqipëri organizatat e shoqërisë civile nisën një sër veprimtarish ndërgjegjëse ...
Vijon në faqen 22

Dhuna ndaj grave në Shqipëri fshihet pas privatësisë familjare



Drafti shqyrtohet me ekspertët e CDU

Projektligji i PD: 3 vite burg kush mban simbolet e komunizmit

"Të hiqet emri i Mehmet Shehut nga rruga në Ballsh, Asim Aliko në Vlorë dhe Ruçi nga Shtëpia me Gjethë"

Nga VALENTINA MADANI

Demokratët po finalizojnë projektligjin e dekomunistizimit, i konceptuar mbi tri shtyllat kryesore: ndalimin e propagandës dhe simboleve komuniste, përcaktimin dhe heqjen e titujve të nderit apo privilegjeve të tjera nga qeveria e shteti të personave përgjegjës për ...
Në faqen 5

DEBITORET/ ABONENTET FAMILJARE DHE BIZNESET, SI SHLYHEN KAMATAT

OSHEE, SKEMA E PAGESES ME KESTE TE FATURAVE

Dokumentet që nevojiten për të lidhur marrëveshjen me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë. Vjedhja e energjisë, procedohen 32 persona



(Në foto) Qytetarë në zyrat e OSHEE

REPORTAZHI

"Daily Mail" në Kukës: Fshati ku çdo familje ka 1 njeri në Angli

Në faqen 8

EURODEPUTETI

Kukan: Çështja 'Tahir' në proces, duhet të kapni 'peshqit e mëdhenj'

Në faqen 4

MISTERI

PD-ja pranon kontratat e lobimit 675 mijë dollarë


Në faqen 4

KRIKITE

Ardian Vehbiu: Polemikë për disa keqkuptime me alfabetin

Në faqen 10-11

"MILOSAO"



Kush ishin dy vëllezërit Gazulli, ambasadorët e Skënderbeut

Suplement

Mbledhja e parë e Dhomës së Tregtisë, i pranishëm edhe presidenti i "Hysenbelliu Group"

Shqipëri-Serbi, shkëmbime 120 milionë euro

Ferra: Eliminojmë pritjet në kufi. Qato: Do jem avokate e sipërmarrjes

Mbi 100 kompani shqiptare dhe serbe morën pjesë në mbledhjen e parë të Dhomave të Tregtisë Shqipëri-Serbi, ku u diskutua për forcimin e bashkëpunimit mes dy vendeve në fushën e tregtisë dhe ekonomisë. Mbledhja u hap nga presidenti i Dhomës së Tregtisë dhe



Industriisë Shqipëri-Serbi, Isuf Ferra. Ai premtoi se Dhoma që drejton do krijojë të gjitha lehtësitat për të nxitur shkëmbimet tregtare mes kompanive të të dyja vendeve dhe do veprojë si urë lidhëse për rritjen e investimeve dy-palëshe. "Akoma ...
Në faqen 7

ISH-ZYRTARET REAGIMET


Taulant Haxhiraj u thoshte bashkëpunëtorëve: Kjo punë bëhet me shtet

Përgjimet e grupit Habilaj zbuluan lidhjet me drejtuesit e policisë

Emrat e 3 ish-zyrtarëve dolën pas përgjimit të bisedave të menaxherit të parcelave me 24 tonë kanabis

TIRANË

Përgjimet e grupit të Habilajve kanë bërë të mundur zbulimin e emrave të tre ish-zyrtarëve të lartë të policisë, të cilët janë shpallur në kërkim. Bëhet fjalë për ish-kreun e bluve të Vlorës, Jaeld Çela; ish-shëf-in e Krimin të Organizuar, Gjergji Kohila dhe ish-shëf-in e Postës Kufitare të Dhërmiut, Sokol Bode. Sipas TV "Klan", Taulant Haxhiraj, i cili menaxhonte parcelat me 24 tonë kanabis të Habilajve të zbuluara në tetor vitit 2016 në Treblovë u thoshte shpesh bashkëpunëtorëve të tij shprehjen: "Kjo punë bëhet me shtet". Pas këtyre sinjaleve, hetuesit e Krimeve të Rënda forcan dyshimet se kultivimi dhe trafikimi i drogës nga Vlora drejt Italisë realizohet me mbështetjen e strukturave policore. Nga thellimi i hetimeve rezultoi se 3 ish-zyrtarët e lartë të Policisë së Vlorës dilnin të përfshirë si bashkëpunëtorë me grupin kriminal të Habilajve. Taulant Haxhiraj, një prej të arrestuarve në vitin 2016 gjatë një operacioni në Treblovë, pritet të ripyetet nga prokuroria lidhur me këtë hetim. Ish-drejtori i Policisë së Vlorës, Jaeld Çela si edhe dy kolegët e tij, Kohila e Bode, tashmë janë në kërkim, pasi efektivet e SHÇBA nuk gjetën vendndodhjen për arrestimin e tyre. Ndaj tre ish-zyrtarëve kanë dalë edhe urdhrat e arrestit të Prokurorisë për Krime të Rënda. Burime nga grupi hetimor shprehën se lista e zyrtarëve policorë mund të zgjatet edhe më tej. Për përfshirje në grupin kriminal Habilaj, më herët Prokuroria e Krimeve të Rënda ka kërkuar nga parlamenti autorizim për heqje e imunitetit të deputetit Saimir Tahiri si dhe autorizimin për arrestimin, heqjen e lirisë dhe kontrollin personal të banesës. Ndaj



Jaeld Çela

Gjergji Kohila

BASHKËPUNIMI

Nga thellimi i hetimeve rezultoi se 3 ish-zyrtarët e lartë të Policisë së Vlorës dilnin të përfshirë si bashkëpunëtorë me grupin kriminal të Habilajve. Taulant Haxhiraj, një prej të arrestuarve në vitin 2016 gjatë një operacioni në Treblovë, pritet të ripyetet nga prokuroria lidhur me këtë hetim.



Sokol Bode me Moisi Habilajn

ISH-ZYRTARËT E POLICISË

Tre ish-drejtuesit e policisë së Vlorës, Jaeld Çela, Sokol Bode dhe Gjergji Kohila kanë qenë nën hetim që prej ditëve të fundit të muajit tetor, si të dyshuar për implikim në aktivitetin e grupit "Habilaj". Mësohet se për afro një muaj, kreu i bluve të qytetit bregdetar, Çela si dhe Bode e Kohila janë mbajtur nën vëzhgim në distancë dhe çdo lëvizje e tyre brenda e jashtë vendit ka qenë e kontrolluar.

SHKURT

Vrau gruan me thikë, 58-vjeçari në gjyq: M'u errën sytë, nuk di ç'kam bërë

TIRANË - Gjykata e Krimeve të Rënda ka lënë në "arrest me burg" Sami Metushin, i cili tri ditë më parë vrau bashkëshorten në fshatin Karpen të Kavajës. Gjatë seancës së djeshme gjyqësore, 58-vjeçari shfaqti pendesë për krimin e kryer, ndërka edhe u përlojt në sallën e gjyqit. Ai tha se me gruan e tij kishin grindje të vazhdueshme. "Unë dhe gruaja kishim 4 vjet që grindeshim. Ditën e ngjarjes m'u errën sytë, nuk di ç'kam bërë", deklaroi Sami Metushi para trupit gjyqësor. Krimi brenda familjes ndodhi pas sherreve të vazhdueshme të bashkëshortëve. Në grindje e sipër, 58-vjeçari goditi me thikë 57-vjeçaren Sose Metushi, nënë e tre fëmijëve.

Vidhet dyqani i celularëve, autorët të pajisur me dorashka dhe kapuçë

TIRANË - Një grabitje ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në kryeqytet. Mësohet se rreth orës 04:30, persona ende të paidentifikuar kanë bastisur një dyqan me pajisje elektronike në Rrugën e Durrësit, në pronësi të shtetasit A.G.J. Pasi kanë thyer derën e dyqanit, ata kanë hyrë brenda dhe kanë marrë disa celularë e tablete dhe më pas janë larguar me shpejtësi. Autorët dyshohet se janë dy dhe kanë qenë të pajisur me dorashka dhe bluza me kapuçë që të mos linin gjurmë. Policia ka shkruar shpejt në vendngjarje dhe ka nisur hetimet për identifikimin dhe arrestimin e autorëve.

Grabitjen dhe dhunën çiftin e të moshuarve, përfundojnë në pranga 2 nga 3 grabitësit

DURRËS - Pak ditë pas grabitjes dhe masakrimit me leva të dy bashkëshortëve Elezi në fshatin Shkallnurr të Durrësit, policia ka vënë në pranga dy persona të dyshuar si autorë të kësaj ngjarjeje të rëndë. Burime policore bënë dje pohan se autorët e krimin janë banorë të qytetit të Durrësit, të cilët kanë pasur të dhëna të plota mbi familjen Elezi. Ndërkaq, blutë nuk bënë me dije emrat e të dyshuarve, por thanë se nga hetimi i kryer është dokumentuar aktiviteti kriminal i këtyre dy personave. Po ashtu, policia ka siguruar prova shkencore për këtë fakt. Arrestimi mësohet se është kryer gjatë orëve të natës duke u gdhirë e shtunë, ndërsa po punohet intensivisht për kapjen e të tretit. Ngjarja për të cilën ata akuzohen ndodhi në orët e para të mëngjesit të së hënës.

Agjencia franceze e lajmeve "AFP": Skandali "Tahiri" dëmton rrugën për në BE

Hetimi ndaj ish-ministrit të Brendshëm të Shqipërisë, Saimir Tahiri dhe lidhjet e tij të dyshuara me trafikun ndërkombëtar të kanabisit dëmtojnë mundësinë e Shqipërisë për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian, kështu shkruan agjencia franceze e lajmeve "AFP". "Vendi i cili është kandidat për në Bashkimin Evropian që prej vitit 2014, ka qëllim të bindë Brukselin që të hapë negociatat me të në fillim të vitit të ardhshëm". Skandali ku është përfshirë Saimir Tahiri, 38 vjeç, ish-ministër i Brendshëm dhe një aleat i afërt i kryeministrit Edi Rama, ka risjellë në vëmendje historikun e vendit për trafikimin e drogës. "Shqipëria ka një problem me lidhjen mes grupeve kriminale dhe politikaneve dhe ky problem nuk është vetëm i një partie", citon AFP fjalët e ambasadorit amerikan




Donald Lu, deklaroi që sipas agjencisë është në kontrast me heshtjen e kujdeshme të ambasadave evropiane, të cilat kanë mbështetur Ramën që kur u shpall kryeministër në vitin 2013. 'AFP' përmend edhe letrën e kryeministrit Rama, që ua dërgoi liderëve të BE-së më herët gjatë këtij muaji, ku shkruante se Shqipëria nuk është më kryeqyteti evropian i kanabisit, ashtu sikurse dëshirojnë ta quajnë disa media. Megjithatë, lideri i

opozitës, Lulzim Basha tha se Shqipëria ka një qeveri me trafikantë droge, e cila duhet të rrezohet dhe t'i lihet hapësirë një qeverie kundër mafies - shkruan agjencia franceze. 'AFP' shton se 6 muaj pas triumfit në zgjedhjet parlamentare, kryeministri duket i dobësuar. Skandali shpërtheu në mes të tetorit me arrestimin e trafikantëve shqiptarë në Itali. Për vite me radhë Shqipëria ka qenë eksportuesi më i madh i kanabisit në Bashkimin Evropian, me së shumti në Itali, sipas raportimeve të Europolit. Në raportin e fundit, Brukseli beson se autoritetet shqiptare dështuan në identifikimin e grupeve kriminale. Kultivuesit e vegjël kapen rregullisht, por asnjëherë kokat e mëdha. Tahiri është zyrtari më i lartë që po hetohet", - shkruan më tej 'AFP' në artikullin e saj.

Tahirit u ngritën akuzat: "Trafikimi i lëndëve narkotike" e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal dhe

"Korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë të shtetit", i dyshuar si i implikuar në trafikun e drogës. Ish-ministri i Brendshëm, Tahiri

përmendej në përgjimet e Habilajve, por Kuventi nuk e dha autorizimin për arrestimin e tij, përveç kontrollit në banesë.



TIRANË - Vetingu në polici ka nisur para janarit, kur sipas Ministrisë së Brendshme, procesi do të nisë zyrtarisht. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar po kthen përgjigje negative për pajisjen me certifikatën e sigurisë të zyrtarëve të policisë të niveleve të ndryshme. "Top Channel" mëson se rreth 40 efektivëve i është refuzuar rinovimi i certifikatave të kategorive "sekret" dhe "tepër sekret". Për këtë arsye, burimet thonë se ditët e fundit ka pasur disa lëvizje në radhët e policisë, që kanë prekur shefin e komisarariatit të Peshkopisë, shefin e kufirit në Dibër, shefin e qarkullimit rrugor në Gjirokastrë, shefin e komisarariatit të Sarandës dhe disa oficerë antidroge në drejtorinë

Lëvizje në radhët e bluve në drejtorinë e 12 qarqeve

Nis vetingu në polici, dështojnë 40 efektivët e parë, nuk marrin certifikatat e sigurisë



Foto ilustruese

LEVIZJET

Mësohet se ditët e fundit ka pasur disa lëvizje në radhët e policisë, që kanë prekur shefin e komisarariatit të Peshkopisë, shefin e kufirit në Dibër, shefin e qarkullimit rrugor në Gjirokastrë, shefin e komisarariatit të Sarandës dhe disa oficerë antidroge në drejtorinë vendore të 12-të qarqeve të vendit.

vendore të 12-të qarqeve të vendit. Për këto lëvizje nuk ka një njoftim zyrtar nga policia. Por, burimet pohojnë se disa prej efektivëve kanë kaluar në dispozicion, ndërsa ligji parashikon që në rast të mo-

spajisjes me certifikatë sigurie, subjekti kalon në një detyrë tjetër, ku nuk njihet me informacione të klasifikuara. Për pajisjen me certifikatë sigurie verifikimet kryehen nga 3 institucione dhe konkre-

tisht: Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave (SHÇBA), Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

Ministri: Në Shqipëri ka shumë grupe të strukturuar kriminale, do i shkojmë deri në fund operacionit "Forca e Ligjit"

Arratia e 3 policëve, Xhafaj: S'ishin nën vëzhgimin tonë

"Të pyetet prokuroria se me kë i ka pasur nën vëzhgim tre ish-shefat"

TIRANË

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafa konfirmoi dje se ka depozituar kallëzim penal për dekonspirimin e arrestimit të tre ish-zyrtarëve të policisë, të cilët prej disa ditësh janë në arrati. Ai ka reaguar në një deklaratë për mediat, në lidhje me akuzat se dekonspirimi i operacionit për vënien në pranga të tre drejtuesve të Drejtorisë së Policisë së Vlorës është bërë nga Policia e Shtetit. Sipas kreut të Ministrisë së Brendshme, tre ish-oficerët: Jaeld Çela, Sokol Bode dhe Gjergji Kohila nuk kanë qenë në vëzhgim nga Policia e Shtetit. Ai deklaroi se prokuroria nuk i ka lënë detyrë policisë që ish-shefat të mbahen nën vëzhgim. "Nuk kanë qenë në vëzhgimin tonë. Në momentin që është vënë në dijeni policia, atëherë ka filluar procesi i mbykëtyrjes nga policia. Përpara këtij fakti nuk ka pasur dijeni policia për një gjë të tillë. Ose më saktë, nuk i ishte lënë policisë kjo detyrë", u shpreh Xhafaj. Ndërkaq, ai pohoi se as Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave (SHÇBA) nuk ka pasur dijeni për urdhër-arrestet deri të mërkurën. "Deri më datë 22 nëntor, kur SHÇBA ka marrë aktet, nuk ka pasur dijeni për këtë gjë. Çfarë ka ndodhur më përpara, duhet të pyesni prokurorinë se me kë i ka pasur nën vëzhgim", tha Xhafaj. I pyetur nga gazetarët se si ka mundësi



Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj

që arratisen në mes ditës tre ish-zyrtarë të lartë të Policisë së Shtetit, kreu i Ministrisë së Brendshme u shpreh se, "ne nuk e dimë në mes të ditës apo të natës. Këtë mund ta dini ju. Nëse keni ndonjë fakt plus, është mirë që t'ia jepni prokurorisë". Fatmir Xhafaj mohoi të ketë emra konkretë se kush e dekonspiroi operacionin për arrestimin e Juelld Çelës, Sokol Bodes dhe Gjergji Kohilës, të tre ish-drejtuës të Policisë së Vlorës, të akuzuar si pjesë e trafikut

ndërkombëtar të drogës nga Habilajt. "Po të kisha emra konkretë, tëjeni të sigurt se nuk do hezitoja t'i çoja atje ku duhen çuar". Gjithashtu, ai pohoi se, "në Shqipëri ka shumë grupe të strukturuar kriminale dhe qeveria është e vendosur t'i shkojë deri në fund operacionit "Forca e Ligjit" për shkatërrimin e segmenteve të krimit. Është një proces, i cili sapo ka filluar. E rëndësishme është se kushdo që i shmanget drejtësisë, duhet të jetë objekti i punës së poli-

DEKLARATA

Fatmir Xhafaj dje deklaroi se as Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave (SHÇBA) nuk ka pasur dijeni për urdhër-arrestet deri të mërkurën. "Deri më datë 22 nëntor, kur SHÇBA ka marrë aktet, nuk ka pasur dijeni për këtë gjë. Çfarë ka ndodhur më përpara duhet të pyesni Prokurorinë se me kë e ka pasur nën vëzhgim", tha ministri i Brendshëm.

ISH-MINISTRI



Dritan Demiraj: Së shpejti do të arrestohen ish-drejtuës qarqesh

TIRANË - Urdhër-arrestet e Prokurorisë së Krimeve të Rënda për ish-drejtuës të lartë të policisë duket se do të pasojnë edhe të tjerat. Ish-ministri i Brendshëm, Dritan Demiraj, në emisionin "Kjo javë" në "News 24", tha mbremë se së shpejti pritet që të dalin urdhër-arreste për ish-drejtuës të lartë të vendit. Ai pohoi se Prokuroria e Krimeve të Rënda pritet të lëshojë urdhër-arreste për disa ish-drejtuës qarqesh. Sakaq, Demiraj shtoi se edhe këta persona janë larguar jashtë vendit. Duke bërë apel që prokuroria dhe SHÇBA të mos "t'ia pasojnë topin" njëri-tjetrit sa u takon rasteve të dekonspirimit të operacioneve për kapjen e personave të dyshuar, ai u shpreh se situata të tilla duhet të marrin fund. Ish-ministri Demiraj tha se duhet të tregohet kujdes jo vetëm për rastin e tre ish-zyrtarëve, por edhe për persona të tjerë që pritet të arrestohen në kuadër të këtij operacioni.

nuk u bë e mundur gjetja dhe arrestimi i tyre nga policia, fakt ky që ngriti dyshime të forta se operacioni është dekonspiruar. Ndërkaq, organi i akuzës ka nisur hetimet edhe për zyrtarë të tjerë të policisë, që kanë akses në informacion dhe mund të kenë

lajmëruar të dyshuarit që të largoheshin. Masa e ndalimit ndaj tre ish-zyrtarëve është dhënë, pasi akuzohen për mosveprim ndaj kultivimit të kanabisit në qarkun e Vlorës, duke lejuar trafikimin e drogës së Habilajve në drejtim të Italisë.

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIRI GODAJ
 Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin për shitjen e pasurisë së palajushme "Pyl" me sipërfaqe totale 551 m², me Nr. Pasurie 62916, Vullmi 9, Fqaje 157, Zona Kadastrale 2460, e ndodhur në Liria, Tiranë, e lene koketë për garancimin e kredisë, për shlyerjen e detyrimit në favor të kreditorit ProCredit Bank Sh.a., për shumën 1202701.28 (një milion e dyqind e dy mijë e shtatëqind e një pike rrezeze e tete) Leka.
 Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandin është në shumën 5730400 (pesë milion e shtatëqind e tridhjetë mijë e katërqind) Leka, e konvertuar në monedhën Euro sipas kursit fille të kombimit valutor të Bankesë së Shqipërisë në datën 02.10.2017 (1 euro = 133.76 leka), në shumën 42840 (dyzetë e dy mijë e tetëqind e dyzetë) Euro.
 Ankandi zhvillohet në datë 06.12.2017, ora 16.00 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, rruga Abdi Toptani, qendra Torre Drin, kt.2 nr.33, Tiranë, dhe për informacion mund të kontakton në nr.0682099471,0695370060, email ermirgodaj@zyrapermbarimit.com.


LOBIMI DEBATI

Vlera, PD: U kontrolluan nga DASH, PS të hetojë, i japim kopjen e kontratës

"Shashka dhe mashtrim", PD-ja pranon kontratat e lobimit me vlerë 675 mijë USD

"Depozitimi në Departamentin Amerikan të Drejtësisë"

Pasi fillimisht i mohoi duke i quajtur mashtrim, Partia Demokratike ka pranuar ekzistencën e dy kontratave dhe pagesave ndaj lobuesit të saj në Uashington, "Muzin Capitol Partners", me vlerë 675 mijë USD, të zbuluara nga një investigim i BIRN. Në një deklaratë për shtyp të shtunën, Partia Demokratike e Shqipërisë pranoi ekzistencën e dy kontratave të lobimit me kompaninë lobuese amerikane "Muzin Capitol Partners", për të cilat opozita shqiptare ka paguar 675 mijë USD. "Kontratat e lobimit të Partisë Demokratike janë dokument publik, që janë të depozituara në Departamentin Amerikan të Drejtësisë", tha PD në një njoftim për shtyp. "Kontratat dhe pagesat e bëra janë subjekt i ligjeve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe janë audituar dhe kontrolluar nga qeveria amerikane", shtoi ajo. Një investigim i BIRN i publikuar të martën zbuloi se Partia Demokratike fshehu pagesa prej më shumë se gjysmë milionë dollarë ndaj 'Muzin Capitol Partners' dhe dështoi të bënte transparencë në KQZ, ndërkohë që njëra prej transfereve rezultoi të jetë bërë nga një kompani guaskë me aksionerë anonimë, e regjistruar në parajsë fiskale. Të dhënat e siguruar nga BIRN tregojnë se pagesat për kompaninë e lobimit u bënë nëpërmjet dy kontratave të lidhura në fund të marsit nga Partia Demokratike dhe një kompani guaskë e regjistruar në Skoci me emrin "Biniatta Trade LP", të cilat kapin një vlerë totale prej 675 mijë USD dhe ku përfshihen tarifatat mujore të firmës, si dhe pagesat për shpenzimet e saj. Kontrata e drejtpërdrejtë e PD-së me "Muzin Capitol Partners" është raportuar në Departamentin e Drejtësisë në SHBA që në muajin mars, ndërsa kontrata me "Biniatta Trade LP" është mbajtur e fshehur për disa muaj dhe është raportuar në mesin e muajit nëntor. Më 14 nëntor 2017, "Muzin Capitol Partners" raportoi në Departamentin e Drejtësisë se ka marrë dy pagesa nga Partia Demokratike, me vlerë totale 525 mijë USD dhe një pagesë



Faksimile e formularit ku "Muzin Capitol Partners" zbardh lidhjen midis PD-së dhe 'Biniatta Trade LP'

"Çështja 'Tahiri', ende në proces" Kukan: Kapni "peshqit e mëdhenj"

Raportuesi për Shqipëri, Eduard Kukan deklaroi dje për "ABC", se institucionet evropiane po përdorin një retorikë shumë pozitive, konstruktive dhe të bukur për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit, por kjo duhet vijuar me rezultate konkrete, se përndryshe do t'i kthehet si bumerang BE-së. Për Kukan, Shqipëria ka ende kohë deri në prill për rezultate konkrete për të hapur negociatat e anëtarësimit vitin e ardhshëm dhe nuk duhet t'a prishë këtë moment. Kukan foli edhe për "peshqit e mëdhenj" në Shqipëri dhe arrestimin e tyre. "Tani po flasim për datat e anëtarësimit, gjë që ishte e pamendueshme disa vite më parë. Tani po flasim për 2025". Komisioneri



Hahn tha në Shqipëri se, "nëse vendet e rajonit duan të anëtarësohen në 2025-ën, atëherë ato duhet të mbarojnë negociatat e anëtarësimit në 2023-shin, pasi procesi i ratifikimit të 27 shteteve anëtare merr dy vjet. Pra, ne po hyjmë në një fazë fare të re", u shpreh Kukan. Po si e sheh ai situatën politike në Shqipëri dhe krye-

të tretë nga "Biniatta Trade LP" në vlerën e 150 mijë USD. Asnjëra prej këtyre pagesave nuk rezultoi e deklaruar në raportin financiar të dorëzuar nga PD në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për zgjedhjet e 25 qershorit, çka ngre dyshime serioze për origjinin e parave. Gjithashtu, mbetet e paqartë se cila është marrëdhënia mes Partisë Demokratike dhe kompanisë "Biniatta Trade LP", e cila është në pronësi të një

zinxhiri kompanish të regjistruara në Belizë, një shtet i Amerikës Qendrore, i njohur si parajsë fiskale. Në një formular të depozituar në Departamentin e Drejtësisë në SHBA më 14 nëntor, "Muzin Capitol Partners" shpjegon se marrëveshja me "Biniatta Trade LP" ishte bërë në emër të Partisë Demokratike të Shqipërisë. "Edhe pse marrëveshja me "Biniatta Trade LP" është deklaruar nëpërmjet ligjit "Për Bërjen Publike

sisht çështjen e luftës së kimit të organizuar dhe çështjen "Tahiri", që e ka përçarë shumë klasën politike shqiptare? "Nuk do të komentoj çështjen 'Tahiri', pasi në politikantë nuk duhet të komentojmë për çështje që janë sërisht në proces. Le të lemë drejtësinë të flasë për këtë. Përgjithësisht, dua të them që Shqipëria ka shanse të mira për vitin e ardhshëm për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Në shkurt komisioni do të publikojë strategjinë e zgjerimit, në prill progresraportet. Pra, kemi më shumë kohë për rezultate", tha z.Kukan. Pyetjes a prisni dhe ju kapjen e "peshqve të mëdhenj", siç ka deklaruar ambasadori amerikan në Tiranë apo edhe komisioneri Hahn më parë, Kukan iu përgjigj: "Po zonjë".

të Lobistëve' (jo ligjit për regjistrimin e përfaqësuesve të agjentëve të huaj, i njohur si 'PARA'), gjatë një rivlerësimi të bërë përpara dorëzimit të 'deklaratave plotësuese' arritëm në përfundimin se përfitues i përfaqësimit ka qenë Partia Demokratike e Shqipërisë", shkruan Muzin Capitol Partners'. E pyetur nga BIRN të martën për kontratat e mësipërme, fillimisht Partia Demokratike mohoi si pagesat në vlerën e



Shfaqja e simboleve komuniste

MBLEDHJA E PËRBASHKËT

Qeveritë e Tiranës dhe Prishtinës, do të takohen të hënën dhe të martën, më datë 27 dhe 28 nëntor, në Korçë dhe Vlorë. Mbledhja e përbashkët do të nisë në orën 16:00 të së hënës dhe në orën 17:15 do të mbahet ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjeve ndërqeveritare, e cila do të pasohet nga një konferencë e përbashkët e dy kryeministrave, Rama dhe Haradinaj.



PD, Çupi: Gjebrea udhëtoi më shumë se 1 herë me makinën e Habilajve

PD-ja akuzoi djeg ish-zv.ministren e Brendshme, deputeten e PS, Elona Gjebrea, se ka udhëtuar më shumë se një herë me makinën e Habilajve. Deputetja e PD, Dhurata Çupi, deklaroi në një dalje për media se Gjebrea ka udhëtuar më shumë se njëherë me makinën e grupit kriminal, i cili akuzohet për trafik ndërkombëtar droge. "Elona Gjebrea ka udhëtuar më shumë se një herë me makinën e Habilajve. Gjebrea sot duhet të përgjigjet: A ndjen përgjegjësi morale e politike për lulëzimin e drogës në Shqipëri? Është koha që Elona Gjebrea të përballet me përgjegjësitë e veta? Krimi në Shqipëri lulëzoi, se me të u bë palë direkt apo indirekt e gjithë qeveria, përshi Elona Gjebrea. Cilado qoftë apo jo përgjegjësia penale e Elona Gjebreas, sot është dita që ajo t'i kërkojë falje popullit të saj dhe të bashkëpunojë me drejtësinë", tha zj.Çupi.

525 mijë USD për "Muzin Capitol Partners", ashtu edhe çdo marrëdhënie financiare me kompaninë guaskë "Biniatta Trade LP". PD i tha BIRN se kishte paguar 125 mijë USD gjithsej për kontratat e saj të lobimit. Përpara se të bënte një kthesë 180 gradë me deklaratën e shtunës, kreu i PD-së, Lulzim Basha deklaroi të premtën se raportimet për kontratat ishin "shashka dhe mashtrim", përveç dy kontratave të

lidhura me "Muzin Capitol Partners". Gjatë të njëjtes periudhë PD ka lidhur edhe një kontratë me kompaninë lobiste "Barnes and Thornburg LLP" në fillim të prillit, me vlerë 150 mijë USD. Në total, shpenzimet e Partisë Demokratike për lobistë në Uashington për periudhën mars-qershor kapin vlerën e 825 mijë USD, më e lartë se të ardhurat totale që Partia Demokratike deklaroi në KQZ.



Valentina Madani

Demokratët po finalizojnë projektligjin e dekomunizimit, i konceptuar mbi tri shtyllat kryesore: ndalimin e propagandës dhe simboleve komuniste, përcaktimin dhe heqjen e titujve të nderit apo privilegjeve të tjera nga qeveria e shteti të personave përgjegjës për diktaturën komuniste dhe krimet e saj, krijimi i mundësive ligjore për penalizimin dhe ndëshkimin e autorëve të krimeve komuniste. "GSH" zbardh disa nga propozimet që do të përfshihen në projektligj ku nuk përfshihet edhe dënimi me tri vite burg kush mban simbolet komuniste. Propozohet heqja e Gramoz Ruçit nga Shtëpia me Gjethe dhe deri tek emri Mehmet Shehut në Ballsh. Për një iniciativë sa më të plotë, demokratët prej disa javësh po bashkëpunojnë me gjermanët, të cilët kanë praktikë shumë-vjeçare jo vetëm në ndalimin e simboleve, por edhe në dënimin e krimeve të nazizmit. Një mekanizëm të ngjashëm synon të ndërtojë edhe Partia Demokratike, bazuar mbi përcaktimet ligjore për torturën, gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit. Pikërisht, me iniciativë të PD-së në bashkëpunim edhe me fondacionin gjerman "Konrad Adenauer" (CDU) dhe shoqatën e Antikomuniste të Përndjekurve Politike po përmbyllet projektligji për dekomunizimin, me qëllim ndarjen e vendit nga e kaluara kriminale e diktaturës komuniste dhe zgjatimet e saj në ditën e sotme. Për herë të parë në përgatitjet një ligji që synon dekomunizimin e vendit po marrin pjesë drejtëdrejtë të përndjekurit politikë, si grupi shoqëror më i interesuar për këtë proces, sipas tyre të vonuar, por të domosdoshëm për të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen e vendit".

ISH-TË PËRNDJEKURIT

Propozimet, Çika: PD 'i marrë parasysh

Ish-të përndjekurit politikë paralajmërojnë se në rast se nuk merren parasysh propozimet e tyre dhe nëse PD-ja çon në Kuvend një ligj pa dakortësinë e Shoqatës së ish-të Përndjekurve Politike, atëherë ata nuk do e njohin atë. Nebil Çika, sryetar i Shoqatës Antikomuniste të Përndjekurve Politike të Shqipërisë deklaroi dje për "GSH" se: "Ne kërkojmë dhe do të këmbëngulim që autorëve të krimeve komuniste, që do të përcaktohen të tillë nga ligji që po përgatitem tu ndalohej pjesëmarrja në politikë dhe në të gjitha institucionet publike e shtetërore. (Është kriminal dhe i papranueshëm që Gramoz Ruçi është vënë me emër dhe foto në Muzeun e Gjetheve për krimet e komunizmit, si një nga autorët kryesorë të tyre dhe zgjidhet kryetar parlament). Ne kemi rënë dakord në parim si me z.Basha, ashtu edhe me z.Alibeaj e anëtarë të tjerë të komisionit, përfshi partnerët e CDU-së, të cilët nga të garantojnë përveç të tjerash edhe përputhjen e ligjit tonë me ato ndërkombëtare". Besoj se iniciativa e z. Basha dhe PD-së për përgatitjen e një projektligji në bashkëpunim me të përndjekurit politikë, si grup i drejtëdrejtë i interesit dhe nën asistencën ndërkombëtare të CDU gjermane, një nga një nga vendet më me përvojë e më serioze në trajtimin e krimeve si të komunizmit, edhe të nazizmit është një zhvillim tejet pozitiv dhe qasje e re e krahut politik antikomunist me të shkuarën komuniste të vendit".

Propozimet, heqja e Ruçit nga Shtëpia me Gjethe, deri tek emri Mehmet Shehut në Ballsh

Drafti i PD: Tri vite burg kush mban simbolet komuniste

Ekspertët e CDU-PD-së: Bëhuni të besueshëm



Ekspertët e CDU-së, në selinë e PD-së

Basha

"Ne kemi kërkuar ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë. Do të kërkojmë konkretisht ndihmën e partnerëve gjermanë. Do të propozojmë shumë shpejt në Kuvend një projektligj për ndalimin, kriminalizimin dhe përdorimin e simboleve të komunizmit sipas ligjit që përdor Gjermania për simbolet e nazizmit", deklaroi kreu i PD-së, Lulzim Basha.

Alibeaj

"Nëse kemi fakte, nëse kemi të dhëna, nëse kemi viktima ende gjallë dhe dëshmi të gjalla të atij sistemi, të cilat përbëjnë vepra penale sipas atyre që ekzistojnë sot në Kodin Penal, mirë është që mekanizmi i procedimit penal të vihet në jetë. Nuk i futem faktit nëse do të japin apo jo votat. Ne do të luftojmë me argumentin", tha Alibeaj.

PROJEKTILIGJI I DEKOMUNIZIMIT, TRI SHTYLLAT KRYESORE

- 1- Ndalimin e propagandës dhe simboleve komuniste.
- 2- Përcaktimin dhe heqjen e titujve të nderit apo privilegjeve të tjera nga qeveria e shteti të personave përgjegjës për diktaturën komuniste dhe krimet e saj.
- 3-Krijimi i mundësive ligjore për penalizimin dhe ndëshkimin e autorëve të krimeve komuniste.
 - Kuvendi i Shqipërisë të miratojë rezolutën e BE-së, që barazon në trajtimin e krimet e nazizmit me ato të komunizmit. Ky do të ishte hapi i parë, që do të çonte në realizimin sipas standardeve euroatlantike krimet e komunizmit në Shqipëri.
 - Përcaktimi me ligj të llojeve të krimeve të konsumuara nga diktaturës komuniste shqiptare, që nuk parashkruhen nga e drejta ndërkombëtare, e njohur edhe nga legjislacioni shqiptar: krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocidit. Të tri këto vepra penale janë konsumuar nga diktatura komuniste dhe për këto ka qindra fakte e prova. Konkretisht, krime lufte: përdorimi i ushtrisë së brigadave partizane pas datës zyrtare të çlirimit nga nazizmi, 29 nëntor 1944. Këto krime janë kryer kryesisht në veri të vendit ku popullsia civile është vrarë, torturuar, burgosur, djegur shtëpi e grabitur prona nga njësi ushtarake të rregullta, siç ishin brigadat partizane apo reparatet e ndjekjes, shpeshherë në bashkonim edhe me forcat ushtarake Jugosllave. (p.sh - rasti i Prek Calit, i diskutuar shumë ditët e fundit).
 - Krime kundër njerëzimit: Pushkatimi e burgosja në shkelje të të gjitha ligjeve të qytetarëve të pafajshëm për dyshime se ishin kundërshtarë të regjimit apo për terror nga ana e qeverisë komuniste dhe veçlage kriminale të saj (rasti masakrës së bombës në legatën sovjetike, në 1952 ku pushkatuan pa gjyq 22 qytetarë të pafajshëm, kryesisht intelektualë, sipas një vendimi të byrosë politike të PKSH-së).
 - Gjenocid: Përndjekja për disa breza deri në shtarosje të familjarëve të kundërshtarëve politikë të diktaturës, kryesisht gra, fëmijë e pleq, Internime, dëbime, shpallje kulakë etj., pa

asnjë vendim gjyq, me vendime politike të PPSH, Frontit Demokratik etj., apo me vendime politike të një komisioni gjithashtu politik (Komisioni i Dëbim- Internimeve). Precedenti, kampet e shtarosjes në masë Tepelena, Kruga etj., ku familjarët e kundërshtarëve politikë të regjimit i izoluan në tela me gjemba dhe u lanë të vdisnin nga uria, sëmundjet dhe torturat. Në Tepelenë vdiqën rreth 400 fëmijë, ndërkohë që në Turan, një nga sekcionet e këtij kampi shtarosjesh vdiqën vetëm në një natë 49 fëmijë. Pati nëna që varrosën brenda ditës nga dy fëmijë.

- Përcaktimi ligjor i këtyre krimeve do t'u krijonte mundësinë individëve apo grupeve të viktimave të ngrinin padit penale nga autorëve të tyre si në gjykatat e prokuroritë shqiptare, edhe në ato ndërkombëtare.
- Ndalimi i simboleve e propagandës dhe nderimi apo privilegjet nga shteti të autorëve të krimeve komuniste. Ne kërkojmë përcaktimin si vera penale të shfaqjes apo demonstrimit publik të simboleve dhe propagandës komuniste.
- Përcaktimi si vepra penale dhe ndëshkimin ligjor të mohimit të krimeve komuniste, një masë që e kanë shumica e ish-vendeve ish-komuniste anëtarë të BE, Lituani, Letonia, Polonia, Hungaria etj.
- Përcaktimi vepra penale (moskallëzim krimi) të të gjithë atyre që kanë marrë pjesë në të ekzekutime të të dënuarve me vdekje, ose që kanë dënuar për ta, të cilët nuk tregojnë se ku janë varrosur ose kanë përfunduar trupat e tyre.
- Heqjen me ligj të emrave të rrugëve, sheshesh shkollave dhe gjitha objektive publike të autorëve të krimeve të komunizmit shqiptarë apo të huaj dhe datave e ngjarjeve përkujtimore komuniste. (Psh., bulevardit kryesor i qytetit të Ballshit e ka emrin 'Mehmet Shehu' apo një nga rrugët e hyrjes në qytetin e Vlorës ka emrin 'Asim Liko'. Është kriminale dhe e papranueshme që Gramoz Ruçi është vënë me emër dhe foto në Muzeun e Gjetheve për krimet e komunizmit si një nga autorët kryesorë të tyre dhe zgjidhet kryetar parlament).

Kodin Penal, që dënojnë çdokënd që i përdor ato. Enkelejd Alibeaj, i cili drejton këtë proces, është shprehur se kjo nismë e PD-së do t'i shërbejë shoqërisë shqiptare. "Që të bëjë minimalisht një pastrim, një purifikim të memories së vet sociale, sigurisht me qëllimin parësor të ndëshkimit të atij sistemi dhe së dyti, më e rëndësishme është për të mos u përsëritur në të ardhmen", u shpreh z.Alibeaj. Anëtarët e tjerë të këtij komisioni të posaçëm të ngritur nga PD-ja janë Nebil Çika, Gazmend Bardhi, Erald Kapri, Akil Kraja. Ata kanë zhvilluar disa herë takime me ekspertët gjermanë, ndërkohë që do të shkëmbejnë edhe email-e në mungesë të takimeve deri në finalizimin e

projektligjit, i cili pritet të përfundojë në datën 29 nëntor, ditë kur jo rrallë në festimet e saj janë shfaqur simbolet komuniste dhe portretet e diktatorit Hoxha. Megjithatë, pritet që brenda 10 ditësh grupi i punës të ketë hartuar draftin, për kriminalizimin e shfaqjes së simboleve të diktaturës.

MODELET

Ekspertët ligjorë të opozitës po shqyrtojnë dhe vlerësojnë modele të ndryshme, kryesisht të Gjermanisë dhe të vendeve ish-komuniste, të cilat kanë ndalur me ligj jo vetëm ekspozimin e simboleve të komunizmit, por edhe të nazizmit. Në disa vende, ligji detyron policinë që do të ndërhyjë për të shpërndarë tubimet dhe për të ndalur shfaqjen e çdo lloji sim-

boli të komunizmit dhe nazizmit, ndërsa disa vende të tjera, si Çekia, parashikon dënim me burg për personat që ekspozojnë simbolet të tilla. Burime brenda grupit të punës bëjnë me dije se po shikohet për adaptimet e një modeli, i cili dënon deri në tri vite burg personat përgjegjës për shfaqjen e simboleve të komunizmit. Disa ditë më parë, kryetari i opozitës, Lulzim Basha zh-

villoi një takim me drejtorin e Fondacionit 'Konrad Adenauer' në Shqipëri, z. Walter Gloss, me qëllim bashkëpunimin dhe ekspertizën gjermane në hartimin e ligjit për ndalimin e simboleve të komunizmit. Në të njëjtën kohë, përfaqësuesit e opozitës kanë kërkuar miratimin e një ligji për dënimin e përgjegjësve për rreth 7 mijë krime gjatë periudhës së komunizmit.

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODOJ

Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandit e dyte për shlyerjen e pasurisë së palajshme "Apartment", me Nr. Pasurisë 5/330-1-5, Zona Kadestrale 85/13, Vll.14, F.q.69, me sipërfaqe 52.02 m², te ndodhur ne P.Sorra/17, Pall.378/1, Shk. 1, Ap.5, Durres, e lene kolateral per garantinim e kredive, per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditorit ProCredit Bank Sh.a., per shumen 1'961'130.58(nye milion e nentqind e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind e tridhjetë pike pesëdhjetë e tetë)Leke dhe 33.63(tridhjetë e tre pike gjashtë)Euro. Çmimi me të cilin fillon ankandit i dyte është ne vleren 15'680(pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) Euro. Ankandit zhvillohet ne date 05.12.2017, ora 16.00 ne zyren e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, rruga Abdi Toptani, qendra Torre Drin, kt.2,nr.33 Tirane, dhe per informacion mund te kontakton ne nr.0682099471/0695370060, email ermirgodaj@zyrapermbarimit.com.

DEBITORET SKEMAT LEHTESUESE

Operatori vijon aksionet kudër vjedhjes së energjisë, OSHEE u rikujton abonentëve skemat lehtësuese

OSHEE, skemë për pagesën me këste të faturës së dritave

Abonentët familjarë dhe bizneset, ja si ndahen pagesat për kamatat

Ornela Manjain

Pagesa me këste e kamatëvonesave për faturat e prapambeturave të energjisë elektrike do të jetë e vlefshme deri në 31 dhjetor të këtij viti. Nderkohë që Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike u kujton abonentëve të lidhin kontrata për të përfituar nga skema e pagesës me këste, duke specifikuar edhe rastet kur ulet kamatëvonesa për abonentët familjarë dhe bizneset. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike lajmëron se abonentët që do të gjenden në shkelje do të ndëshkohen. Kështu, vetëm dje grupet e Task Forcë, në prani të policisë gjyqësore kanë proceduar 32 abonentë nga Ballshi, Fieri, Roskoveci, Patosi, etj. Këta shtetas janë shoqëruar në polici, pas procesverbalit të hartuar nga Task Forcë e OSHEE dhe përfaqësues të policisë gjyqësore mbi shkeljen e bërë, në kundërshtim me nenin 137 të Kodit Penal. Vjedhjet e konstatuara janë kryesisht: cenim i matësit, ndërhyrje në matës për të manipuluar të dhënat, lidhje të paligjshme, furnizim pa pasur kontratë me OSHEE, etj.

ABONENTËT FAMILJARË

Për kategorinë e abonentëve familjarë, skema parashikon ndarje të kësteve në mënyrë të barabartë, në varësi të shumave. Kështu, në rast se familjari e paguan të gjithë detyrimin njëherësh, i ulet kamatëvonesa me 70%. Dhe në rast se abonentit do të paraqitet brenda 6 muajve nga firmosja e aktmarrëveshjes për paguar detyrimin, atëherë do të përfitojë 50% të reduktimit të kamatës në datën e mbylljes së detyrimit. Nderkohë që dokumentacioni i nevojshëm për të përfituar nga skema është kopje e librezës ose e faturës së fundit. Ndërsa, në rastet kur mbajtësi i kontratës në sistem nuk është i njëjti me personin që është mbajtësi, atëherë kërkohet edhe dokumenti i pronësisë në një nga



Foto ilustruese

KLIENTIT I DUHET TË PARAQESË

1. Kartën e identitetit, nëse është personalisht në sportel.
 2. Autorizim me shkrim nga mbajtësi i kontratës dhe kartën ID të klientit dhe të personit që do të paraqitet për pagesë.
- PËR FITUESIT DHE DOKUMENTET**
Abonentët që nuk kanë lidhur ende marrëveshje me OSHEE për shlyerjen e detyrimeve duhet të plotësojnë një sërë dokumentesh në varësi të kategorisë ku mund të përfitojnë.
- PENSIONISTËT KRYEFAMILJARË**
Të paguajnë këste më të vogla se skemat e mëparshme, duke u hequr të gjithë kamatëvonesën kundrejt pagesës 20 lekë.
- DOKUMENTET**
1. Paraqitja në sportelet e OSHEE për përditësimin e të dhënave të kontratës së furnizimit me energji elektrike.
 2. Paraqitja e certifikatës familjare, ku të përcaktohet që pensionisti është kryefamiljar dhe datat e shkëputjes nga trangu i familjes i pjesëtareve të tjerë, e cila duhet të jetë para datës 1.12.2015.
 3. Paraqitja e kartës ID dhe librezës së pensionit.
 4. Konsumatori duhet të jetë mbajtës i kontratës së furnizimit me energji elektrike, ose përdorues i pronës për më shumë se 3 muaj nga data e aplikimit për AKM.
 5. Paraqitja e dokumentacionit që kanë përfituar ose jo kompensim për faturat e energjisë elektrike në muajin e fundit.

format ligjore të tyre që janë parashikuar në procedura.

KATEGORIA PRIVAT
Për klientët e lidhur në Tension të Ulët (TU) ofrohet pagesë me këste sipas masës së detyrimit. Produktet për bizneset e lidhura në Tension të Mesëm (TM) mbeten të pandryshuar dmth., afati maksimal i ripagesës, ba-

zuar në detyrimin ligjor për dalje nga rrjeti i OSHEE - 20 KV deri në fund të vitit 2016 dhe 10/6 KV deri në fund të vitit 2017. Për herë të parë, biznesit (kategoritë TU dhe TM) i jepet mundësia t'i reduktohet me 50% kamatëvonesa, nëse paguan të gjithë detyrimin njëherësh. Dokumentacioni i

nevojshëm për të lidhur kontratën është kopje web e QKR të shoqërisë ose personit fizik, identifikimi i administratorit të shoqërisë ose personit fizik. Për SHPK dhe SHA duhet autorizimi nga organet përkatëse për lidhjen e AKM dhe identifikimi i të autorizuarit, nëse ka të tillë.

KATEGORIA BUXHETOR DHE JOBUXHETOR

Afatet e ripagesës nuk kalojnë datën 30 prill 2019 për bashkitë. Sipas OSHEE, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe shoqëritë me kapital shtetëror, afatet e ripagesës janë sipas tabelës si më poshtë: Në rast

ripagesë të detyrimit total nga të gjitha kategoritë, ofrohet reduktim i kamatës në masën 50%. Për lidhjen e AKM, këto kategori të drejtohen në Drejtorinë Qendrore të Tiranë, pranë sektorit të mbledhjes së debisë të buxhetore dhe jobuxhetore, në departamentin e shitjes dhe arkëtimeve.

PAGESAT ME KËSTE

SKEMA E PAGESËS ME KËSTE - FAMILJET

Deri në:

■ 100 mijë lekë	12 muaj/këste
■ 200 mijë lekë	24 muaj
■ 300 mijë lekë	36 muaj
■ 400 mijë lekë	48 muaj
■ 500 mijë lekë	60 muaj
■ 600 mijë lekë	72 muaj
■ 900 mijë lekë	84 muaj
■ 1 milion lekë	96 muaj
■ 1.5 milionë lekë	108 muaj
■ 2 milionë lekë	120 muaj
■ 2.5 milionë lekë	132 muaj
■ 3 milionë lekë	144 muaj
■ 3.5 milionë lekë	156 muaj
■ mbi 3.5 milionë lekë	168 muaj

SKEMA PËR PRIVATIN

Deri në:

■ 200 mijë lekë	12 muaj/këste
■ 500 mijë lekë	12 muaj
■ 1 milion lekë	24 muaj
■ 1.5 milionë lekë	36 muaj
■ 2 milionë lekë	48 muaj
■ 3 milionë lekë	60 muaj

Shoqëria përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme:

Pasurisë me Nr.3/369 e Ilajt "Trulli + Banesë 3 katëshe" me sip. trulli 350 m² dhe sip. banesë 191.9 m², (kali përdehe 191.9 m², kali i 1.269.03 dhe katil 269 m²) ndodhur në Ll. "11 Janari", ZK. 2310, Kuçovë, në pronësi Agim Isa Zeqja. Cmimi fillestar në ankandin e trete është 10,080,000 Lekë. Ankandi zhvillohet në datë 18.12.2017, ditën e Hene ora 15:30 në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë.

Për info, Tel:044503458 ose E-mail shoqeripermbarimoreafa2010@gmail.com

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PERGJITHSHME E PERMBARIMIT
ZYRA PERMBARIMORE TIRANE

Zyra e Përmbarimit Tiranë, me përbarues gjyqësor Albert Fejzo, në baze të vendimit nr. 10019, datë 16.11.2017, shpall shitjen në ankand të pasurisë apartamentit të banimit me sipërfaqe 57 m² të ndodhur në Rrugën: "Irfan Tomini", pallati 10/2/60 në Zonen kadastrale 8260 të regjistruar Zyra Vendore Regjistrimit Pasurisë Paluajtshme Tiranë me nr pasurie nr.2/54-4-60, volume 6, faqe 82 Tiranë, në vlerën 2.800.000 (dy milion e tetëqind mijë) Lekë.

Ankandë zhvillohet në ambientet e Zyres të Përmbarimit Tiranë, në adresën: Sheshi Mustafa Ataturk, kryeqezimi "21 dhjetori", Tiranë ditën e Premte, me datë 08.11.2017, ora 16.00.

Njoftim për shitje me ankand

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin për pasurinë e debitorit V Gjikas, P Gjikas

Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga:

- "Apartment" me numër pasurie 31/202+1-6 faqe 160 Vol 44, në ZK 8602 me sipërfaqe 63.19 m² në Vlorë

Ankandi i pasurisë fillon me cmimin fillestar në masën 32.880 Euro Ankandi do të zhvillohet datë 07.12.2017 orën 15:00, selin e shoqërisë "pall Gora" Bulv "Gj. Fishta" Kulla 3, Tiranë. Ofertuesit duhet të tërheqin dokumentacionin të kontaktojnë me tel. 00355 67 20 82 543 ose e-mailit ilir.dervishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com.

Mbledhja e parë e Dhomës së Tregtisë mes dy vendeve, diskutohet për bashkëpunimin ekonomik

Shqipëri-Serbi, 120 milionë euro shkëmbime tregtare gjatë 2017

Isuf Ferra: Do punojmë për eliminimin e pritjeve në pikat kufitare

Mbi 100 kompani shqiptare dhe serbe morën pjesë në mbledhjen e parë të Dhomave të Tregtisë Shqipëri-Serbi, ku u diskutua për forcimin e bashkëpunimit mes dy vendeve në fushën e tregtisë dhe ekonomisë. Mbledhja u hap nga presidenti i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Serbi, Isuf Ferra. Ai premtoi se Dhoma që drejton do krijojë të gjitha lehtësirat për të nxitur shkëmbimet tregtare mes kompanive të të dyja vendeve dhe do veprojë si urë lidhëse për rritjen e investimeve dypalëshe. "Ako ma mbetet shumë për t'u bërë lidhur me përmirësimin e efikasitetit të shkëmbimeve tregtare midis dy vendeve. Për shembull, në eliminimin e pritjeve në pikat kufitare, të cilat mbartin kosto të larta për biznesin. Nisur nga ky fakt, po punojmë dhe do angazhohemi më fort në organet shtetërore për të lehtësuar procedurat, duke bërë që të ndërmjetësojmë minimizimin e këtyre kostove. Një tjetër ngërç është dhe mosshfrytëzimi siç duhet i portit të Durrësit. Ne do punojmë më tej që ky port i Adriatikut, i kombinuar edhe me korridorin efikas të transportit, Rrugën e Kombit dhe hekurudhën të shndërrohet në një portë hyrëse dhe dalje shumë të vlefshme për dy vendet tona", tha zoti Ferra në fjalën e tij. Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Sonila Qato u zotua se do të jetë avokate e sipërmarrjes vendëse dhe të huaj. "Tregtia dypalëshe ka pasur zhvillim të qëndrueshëm, duke arritur në 118.6 milionë euro në periudhën janar-shtator 2017. Një rritje domethënëse, krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë. Zyra e ministres së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes të cilën përfaqësoj, do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për plotësimin e detyrës si një avokate e sipërmarrjes vendëse dhe të huaj në vendin tonë për garantimin e mbarrëvajtjes së dy realiteteve ekonomike, të cilat tashmë vijnë nga afër njëri-tjetrit. Ndaj, ju ftoj të trokisin sa herë të jetë e nevojshme për kërkesa, sugjerime diskutime apo çfarëdo lloj tematikë që ju e shikoni të nevojshme e për të rritur këtë bashkëpunim reciprok midis sipërmarrjeve të dy vendeve tona", theksoi



Mbledhja e parë e Dhomës së Tregtisë Shqipëri-Serbi

BASHKËPUNIMI

Në këtë takim të rëndësishëm ishte i pranishëm ministri serb i Ekonomisë, Goran Knezevic, si dhe biznesmenë serbë e shqiptarë, mes tyre edhe Presidenti i "Hysenbelliu Group", Irfan Hysenbelliu. Për ministrin serb të Ekonomisë, Goran Knezevic e ardhmja e dy vendeve tona është Bashkimi Europian, ndaj ai kërkoi që Shqipëria dhe Serbia t'i zgjidhin sfidat politike-ekonomike me dialog në funksion të së ardhmes së përbashkët.

ministrja Qato.

TAKIMI

Në këtë takim të rëndësishëm ishte i pranishëm ministri serb i Ekonomisë, Goran Knezevic, si dhe biznesmenë serbë e shqiptarë mes tyre edhe Presidenti i "Hysenbelliu Group", Irfan

Hysenbelliu. Për ministrin serb të Ekonomisë, Goran Knezevic e ardhmja e dy vendeve tona është Bashkimi Europian, ndaj ai kërkoi që Shqipëria dhe Serbia t'i zgjidhin sfidat politike-ekonomike me dialog në funksion të së ardhmes së

përbashkët. "Evropa këtë rajon e sheh si një tërësi dhe prandaj interes të përbashkët kemi të bashkëpunojmë që sfidat politike dhe ekonomike t'i zgjidhim me dialog dhe me bashkëpunim. Është e nevojshme që t'i thellojmë marrëdhëniet në bazë

Asambleja e përgjithshme e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Serbi

Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Sonila Qato ka postuar një status në 'FB', ku pohon se hapja e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Serbi tejkalon diferencat politike. "Në prani të presidentit të Dhomës së Tregtisë Shqipëri-Serbi, z. Isuf Ferra; kryetarit të Dhomës së Tregtisë serbe, Z. Marko ?ade"; kryetares së Unionit të Dhomave, znj. Ines Muçostepa; ministrit të Ekonomisë serbe, z. Goran Knezevic dhe mbi 100 anëtarëve të kësaj Dhome, u çelën punimet për asambleen e parë të përgjithshme. Ky bashkëpunim dëshmoi se sipërmarrësit dinë të tejkalojnë diferencat politike në emër të një ekonomie gjithmonë e më globale, gjetjes së tregjeve të përbashkëta dhe bashkëpunetorëve afatgjatë", - shkruan Qato.



të interesave dhe qëllimeve të përbashkëta për të ardhmen tonë në Bashkimin Evropian. Kemi shumë sfida me të cilat ballafaqohemi, por ne duhet të fokusohemi në ndërtimin i së ardhmes më të mirë për qytetarët tanë", u shpreh

ministri serb i Ekonomisë. Në fund të takimit të Tiranës, Isuf Ferra u rikonfirmua si kryetar i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Serbi, ndër-nda Miroslub Aleksic mori miratimin e të pranishmëve si bashkëkryetar.

Formalizmi i tregut dhe rritja e akcizës, ndikim në çmim

Rritet çmimi i cigareve, Tatimet konsultim me bizneset

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve u zhvillua një takim konsultativ me një përfaqësi të furnizuesve kryesorë të cigareve në vend. Fokus i bisedimeve gjatë këtij takimi ishin ndryshimet e parashikuara në Paketën Fis-kale 2018, të cilat prekin këtë sektor. Vëmendje e veçantë iu dedikua zbatimit të skemës së furnizimit të cigareve, kryesisht detyrimit për deklarimin dhe pagesën e TVSH-së për gjenëjen e stokut nga furnizuesit e cigareve pas

efekteve të ndryshimit të çmimit. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe përfaqësia e furnizuesve të cigareve dakorduan të shqyrtojnë një paketë propozimesh, e mbërritur nga kjo e fundit për lehtësimin dhe zbatimin korrekt të të gjithë zinxhirit operacional konform kuadrit ligjor dhe praktikave më të mira tatimore në rajon e më gjerë, përfundon njoftimi i tatimeve. Çmimet e cigareve u rriten masivisht këtë javë me rreth 15 për qind për paketë. Të gjitha pikat e shitjes me pakicë po i shesin paketat me

30-40 lekë më shtrenjtë, duke lajmëruar se një valë e re rritjeje do të vijojë edhe pas vitit të ri. Distributorët e mëdhenj kanë argumentuar për tregtarët si arsye kryesore të rritjes së çmimeve procesin e formalizimit. Brenda kësaj rritjeje po spekulohet me ndryshimin e akcizës, pasi rritja e pritshme për vitin 2018 përfshin vetëm cigaret e luksit, purot. Distributorët e mëdhenj pohojnë se nuk i kanë ndryshuar çmimet dhe kjo rritje po vjen si spekulim nga pakica. Sipas shpjegimeve që japin tregtarët e pakicës, for-



Takimi i Tatimeve me biznesin

malizimi duket se është shkaku kryesor. Qeveria shqiptare tre muajt e fundit ka ndërmarrë fazën e dytë të aksionit anti-informalitit. Aksioni është përqendruar në subjektet e tregtisë me shumicë dhe pakicë, pasi sipas

analizës së riskut, këto janë sektorët me evazivë në vend. Tregtarët pohojnë se koston e formalizimit po reflektohen në çmime, pasi përveç cigareve, çmimet po rriten edhe për disa artikujt ushqimorë industrialë.

SHPALLJE ANKANDI

Shoqëria Përmbarimore "Enforcement Group" sh.p.k. shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të llojit Ndërtëse, me Nr. 213/33-ND, volumi 17, faqe 150, ZK 3976, me sipërfaqe 240.50 m² cdo kat, viës 4 katëshe, adresa e pasurisë Shkoçëz, Tiranë, në pronësi të Remzi Adil Muça. Çmimi me të cilën del kjo pasuri në ankandin e parë është 60,028,800 (gjashtëdhjetë milion e njëzet e tetë mijë e tetëqind) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Enforcement Group" sh.p.k. në adresën Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla Nr. 1, Pallati e Shoqërisë "Gora", Kati 3, Ap. 14, Tiranë në datën 30.11.2017, ora 16.00. Për kontakt: Cel: 069208756; email: enforcementgroup2014@gmail.com

NJOFTIM SHITJE ME ANKANDI

Ne date 04.12.2017 ne oren 16.00 ne zyren e permbaresit gjyqesor privat Irida Tereziu PF me adrese ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit "Apartament" me sip.68 m², me nr.pasurie 2/166+1-5, ne zonen kadastrale 3682, me volum 2, faqe 54, i ndodhur ne Lagjia 11 Shtatori, pallati 9, shikalla 1, kati 2, apartamenti 5, Ure Vajguore Berat.Cmimi ne ankand te trete eshte ne vleren 1,411,200 (nje milion e katerqind e njeqind e njeqind) lekë.

NJOFTIM SHITJE ME ANKANDI

Njoftim: Ne date 01.12.2017 ne oren 16.00 ne zyren e permbaresit gjyqesor privat Irida Tereziu PF me adrese ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit llojit "Apartament" me siperfaqe 52.01 m², me volum 1, faqe 175, numer pasurie 1/214+2-15, ne zonen kadastrale 1664, me adrese Lagjia "Puntoni", Pll.14, Shk.2, Kt.3, Ap.15, Fushe Kruje.Cmimi ne ankand te dyte eshte ne vleren 1,361,671.36 (nje milion e treqind e gjashtedhete e nje mije e gjashteqind e shtatedhete e nje pike tridhete e gjashte) lekë.



Publikime të ndryshme në rrjetet sociale nga shqiptarët në Britani



Apeli/ Zv.ministrja e Brendshme, Rovena Voda: Ktheni në atdhe fëmijët nën 18 vjeç të pashoqëruar

"Fshati ku çdo familje ka 1 anëtar në Angli"

Reportazhi i "Daily Mail" për emigracionin ilegal nga Shqipëria në Britani

Juliana Knezi

Shqiptarët që udhetojnë ilegalisht drejt Britanisë së Madhe janë vënë sërisht në vëmendjen e prestigjiozës "Daily Mail". Kjo e fundit u ka kushtuar një artikull emigrantëve ilegalë, teksta futen në territorin e Anglisë. Madje, "Daily Mail" shkruan se shqiptarët nuk ngurojnë që të publikojnë në rrjetet sociale dhe selfie nga udhëtimet e tyre.

"Duke qeshur, duke mbajtur shishe me pije dhe me flamurin shqiptar, selfiet e të rinjve janë në faqe të cilat mund të arrijnë 60,000 ndjekës. Dje edhe qeveria shqiptare e quajti Britaninë një vend i arritshëm lehtë krahasuar me shtetet e tjera dhe i kërkoi Britanisë të lthejë sa më shpejt emigrantët shqiptarë në atdhe. Ndërkohë, familjet atje e kanë pranuar hapur dërgimin e fëmijëve të tyre në mënyrë ilegale në Britani për të gjetur një jetë më të mirë. Shumë përfundojnë në qendra kujdestarie, sipas një investigimi të "Daily Mail". Disa janë të detyruar të punojnë si trafikantë droge për bandat e krimt shqiptar, të cilat policia britanike i përshkroi kohët e fundit si "bandat më të pamëshirshme që Britania e Madhe ka parë ndonjëherë", thuhet në shkrimin e "Daily Mail". Po ashtu, "Daily Mail" flet edhe për një fshat të Shqipërisë, Krume, ku sipas saj pothuajse çdo familje ka të paktën një anëtar në Britani. "Rrethuar nga malet me borë, Kruma është 'periferia' më e largët e Londrës", shkruan me tej "Daily Mail". Britanika e paraqet këtë zonë si një vend pa të ardhme për rininë, duke u dhënë atyre mundësinë e vetme për t'u larguar.

NJE DITE NE KRUME

"Kruma tashmë i ngjason një lagjeje periferike të Londrës, paqka se është 1600 kilometra larg kryeqytetit britan-



Faksimili e faqes zyrtare të "Daily Mail", ku shkruan për shqiptarët

ZV.MINISTRJA E BRENDSHME

Zëvendësministrja e Brendshme shqiptare evidenton si një problem të madh në këtë çështje edhe mediat sociale, për shkak të paraqitjes së një imazhi fals të jetës në Britani.

"Njerëzve iu pëlqen të duken dhe të inkurajojnë adoleshentët të shkojnë atje. Ata mendojnë se do të jetë mahnitëse, kur nuk është ashtu", tha Voda.



ik", shkruhet në artikull. Zyratë drejtorisë arsimore në Kukës kanë pohuar se nga viti 2013 deri në 2016 janë larguar në drejtim të Anglisë 834 nxënës të shkollave 9-vjeçare. "Daily Mail" nënvizon se këta të rinj për të paguar biletën e udhëtimit prej 12.000 euro bien për e grupeve të organizuara kriminale, duke i përdorur si korrierë droge. Kjo gazetë britanike ka intervistuar edhe zv.ministren e Punëve të Brendshme, Rovena Voda, e cila ka shpjeguar përse ky trend rritjeje i të rinjve shqiptarë që synojnë të shkojnë në Angli. "Britania

duhet të reagojë akoma edhe më mirë me deportimin e të rinjve, të cilët nuk janë trafikuar kundra dëshirës së tyre. Ata shkojnë atje për arsye ekonomike. Arsyetja për shumtë të rinj zgjedhin Anglinë dhe jo Francën, Gjermaninë apo Holandën lidhet me faktin se këto vende kanë një sistem dëbimi më të shpejtë", ka deklaruar Voda. Zëvendësministrja ka theksuar se deri më tani janë dërguar për ndjekje penale 50 prindër, të cilët kanë lënë fëmijët e tyre rrugëve të Europës për të kërkuar azil. Qëndrimi i butë i Britanisë po nxit të rinjtë sh-

qiptarë të shkojnë në drejtim të saj. Kjo është deklarata që Zëvendësministrja e Brendshme, Rovena Voda, ka dhënë për "Daily Mail" pas reportazhit për emigrantët e paligjshëm në Britani. Voda tha se Britania duhet të veprojë më shpejt për t'i kthyer në Shqipëri të rinjtë nën 18 vjeç të pashoqëruar, të cilëve iu është refuzuar azili, ashtu siç vepron Franca dhe Gjermania. "Duke mos vepruar kështu, Britania shndërrohet për adoleshentët në një vend më tërheqës. Britania mund të kursëjë para duke mos paguar përkujdesje sociale për këta të rinj, para të cilat mund t'i investojë në projekte në Shqipëri, në mënyrë që të inkurajojë adoleshentët të qëndrojnë në vendin e tyre. Këta fëmijë nuk po trafikohen në Britani kundër dëshirës së tyre. Pjesën më të madhe i dërgojnë vetë prindërit apo të afërmit e tyre. E bëjnë këtë për arsye ekonomike. Ata besojnë se po bëjnë më të mirën për të ardhmen e fëmijëve të tyre, por po iu shkaktojmë

dëm psikologjik duke i braktisur ata", është shprehur zëvendësministrja e Brendshme. Voda ka shtuar se ka raste kur këta fëmijë përfshihen në krim, nëse nuk fitojnë azilin. Sipas saj, prindërit mendojnë se duke çuar fëmijët të parët do ta kenë më të lehtë të marrin azilin dhe ata të shkojnë më pas. Zëvendësministrja e Brendshme shqiptare evidenton si një problem të madh në këtë çështje edhe mediat sociale për shkak të paraqitjes së një imazhi fals të jetës në Britani. "Njerëzve u pëlqen të duken dhe të inkurajojnë adoleshentët të shkojnë atje. Ata mendojnë se do të jetë mahnitëse, kur nuk është ashtu", -tha Voda. E përditshmja britanike "Daily Mail" pasi ka botuar foto të të rinjve rrugës për në Britani, të fshehur nëpër kamionë apo diku tjetër, ka dërguar gazetarin e saj në Krumë të Shqipërisë, i cili ka dëgjuar prindër të pranishëm hapur se i dërgojnë fëmijët e tyre në Britani për një jetë më të mirë.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

PASURINË NR. 2/963-ND-1-43, E LLOJIT 'APARTAMENT', VOLUMI 55, FAQE 73, ZONA KADASTRALE 8513, ME SIPERFAQE 67,81 M2, NË ADRESËN: RRUGA "K. KËRTUSHA", SHKALLA 1, KATI 7, DURRËS, NË PRONËSI TË SHITËSASVE: Z. LUTFI GJYZELI DHE ZNJ. ENKELEJDA GJYZELI

ÇMIMI 4.000.000 LEKË, Data e zhvillimit të ankandit do jetë 05.12.2017.

ZYRA PERMBARIMORE GJYEQESORE PRIVATE 'LILA ELEZI'
Adresa: Biv. "Gjergj Fishta", Pallati "GORA", Kulla 1, Kati 2, Tirane.
Cel: 0684202666; 0693262866

EPSA SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"
SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:

- Apartment** me sip. 147 m², ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8270, Numri Pasurisë 3/40+1-16, Volum.42, Faqe.56. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Banka Intesa SanPaolo Shqiptari sha. Çmimi me të cilin do të fillojë ankandi III është **148.176 Euro**.
- Garazh, Nr.1** me sip. 520 m², Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurisë: 3/241-G1, vol.18, faqe.72. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Banka Intesa SanPaolo Shqiptari sha. Çmimi me të cilin do të fillojë ankandi III është **445.536 Euro**.
- Njësi** me sip. 50 m², ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurisë: 3/241-N2, vol.18, faqe.76. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Banka Intesa SanPaolo Shqiptari sha. Çmimi me të cilin do të fillojë ankandi III është **120.960 Euro**.
- Garazh N.2** me sip. 50 m², Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurisë: 3/241-G2, vol.18, faqe.73. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Banka Intesa SanPaolo Shqiptari sha. Çmimi me të cilin do të fillojë ankandi III është **42.840 Euro**.
- Garazh N.3** me sip. 570 m², Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurisë: 3/241-G3, vol.18, faqe.74. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Banka Intesa SanPaolo Shqiptari sha. Çmimi me të cilin do të fillojë ankandi III është **488.376 Euro**.
- Apartment** me sip. 402,9 m², Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurisë 3/241+1-1, Volum.18, Faqe.78. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Banka Intesa SanPaolo Shqiptari sha. Çmimi me të cilin do të fillojë ankandi III është **731.022 Euro**.
- Njësi** me sip. 310 m², Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurisë: 3/241-N1, vol.18, faqe.75. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Banka Intesa SanPaolo Shqiptari sha. Çmimi me të cilin do të fillojë ankandi III është **750.920 Euro**.
- Njësi** me sip. 364,7 m², Vendndodhja: Rruga "Niko Lena", hyrja 1, Tirane, ZVRPP Tirane, Zona Kadastrale: 8250, Numri Pasurisë: 3/241-N3, vol.18, faqe.77. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Banka Intesa SanPaolo Shqiptari sha. Çmimi me të cilin do të fillojë ankandi III është **827.139 Euro**.

Ankandi për të gjitha pasuritë e sipërcituara do të zhvillohet datë 05.12.2017 ora 16.00 në zyrat e shoqërisë EPSA shpk të ndodhura në adresën Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6.Tirane.

Qeveria e Shkupit bën një hap prapa, jo dygjuhësi në të gjitha institucionet

Absolutisht nuk do të ketë dygjuhësi në të gjitha institucionet në tërë territorin e RM-së. Ligji për gjuhët është në pajtim me Kushtetutën dhe me të vetëm do të avancohen disa nevojat praktike të qytetarëve, që deri më tani nuk kanë qenë të mundura", tha sot kryeministri Zoran Zaev, duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve.

Kryeministri konfirmoi edhe se do të përcaktohet juridikisht-formalisht ansambël i kulturës për qytetarët shqiptarë.

"Ligji për gjuhët është në pajtim me Kushtetutën. Aty ku do të ketë nevojë praktike dhe Kushtetuta e lejon këtë, ligji kështu edhe do të realizohet. Përmes tij mundësohet realizimi i disa nevojave që deri tani kanë qenë të pranishme tek qytetarët, ndërsa nuk janë mundësuar. Ky është avancimi i përdorimit të gjuhëve në RM dhe gjithësi, ku ekzistojnë ansamble, pa rritjen e mjeteve të buxhetit, vetëm se do të përcaktohet juridikisht-formalisht ansambël kulturor i shqiptarëve", theksoi Zaev pas nënshkrimit të marrëveshjeve për përkrahjen e bujqve të rinj në Ministrinë e Bujqësisë Pyjeve dhe Ekonomizimit të ujërave.

"Ligji për përdorimin e gjuhëve, ashtu siç është propozuar, është vetëm truket manipulativ për shqiptarët

Zaev: Nuk do të ketë gjuhë shqipe në të gjithë Maqedoninë

Qëndrim zhgënjyes i kryeministrit maqedonas



Kryeministri Zoran Zaev

nga ana e koalicionit udhëheqës", u shpreh Ilija Dimovski nga VMRO-DPMNE. Dimovski mbetet me qëndrimin se ligji i propozuar është kundër kushtetues, transmeton "Ex-

press". "Ai që e ka shkruar ligjin, shpresoj se aty ka pasur ndonjë shqiptar, ka harruar të shkruaj se udhëzuesit e medikamenteve të cilat do t'i lexojnë sh-

PROPOZIMI

Ligji për përdorimin e gjuhëve në publik, por edhe në rrjetet sociale shkaktoi reaksione të mëdha, veçanërisht pas zhdukjes së propozimit nga rendi ditor i punës në Kuvend, pak kohë pas largimit të eurokomisionerit Johannes Han, i cili përmendi se qeveria duhet të fokusohet për sjelljen e ligjeve reformuese.

është bërë për shkak të nevojës së qytetarëve, për të cilën nuk e mohoj se ekziston", tha Ilija Dimovski, VMRO-DPMNE.

Analisti Alajdin Demiri gjatë pjesës më të madhe të debatit mudohej që ta tregonte problemin me të cilin përballen shqiptarët në Maqedoni. Sipas tij, problemi daton nga shumë më herët. Demiri thotë se shqiptarët janë të diskriminuar, pasi nuk u lejohej të përdorin çdo kund gjuhën e tyre amtare.

"Tani u hapën tema se kërkesa që shqiptarët ta përdorin gjuhën e tyre është imponim që edhe maqedonasit duhet ta dinë atë. Gjë që nuk është aspak e vërtetë. Ai nuk është ligj për përdorimin e gjuhëve, por për rregullimin e marrëdhënieve të punës, ligj për përdorimin e disa rregullave.

Ose të flasin mes tyre në gjuhën angleze", tha analisti Alajdin Demiri.

Gazetarja Mira Kostiq tha se nuk ka asgjë kundër gjuhës shqipe, por thotë se duhet të kufizohet se ku do të mund të përdoren të gjitha gjuhët e tjera, përveç gjuhës maqedonase, e cila duhet të jetë zyrtare.

"Të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë duhet të jenë të barabartë para ligjit dhe Kushtetutës para ligjit t'i kenë të gjitha të drejtat e njëjta dhe të kenë obligime të njëjta. Kjo është e thjeshtë zotëri Demiri, ndërsa përdorimi i gjuhës është definitivisht e drejtë, e cila i përket gjithkujt që nga lindja", tha Mira Kostiq, gazetare.

Todor Pendarov shprehu dëshpërim që të rinjtë, posaçërisht ata shqiptarë, e flasin shumë më pak gjuhën maqedonase. "Edhe pse e mësjojnë në shkollë, ata flasin dhe komunikojnë në gjuhën maqedonase shumë pak.

Nëse jetojmë së bashku këtu, atëherë si është e mundur për shembull në Tetovë, Gostivar, Dibër, Kërçov dhe pjesërisht në Shkup ku jetojnë 20% shqiptarë, ndërsa diku edhe më shumë, diku jetojnë 20% maqedonas, fëmijë të cilët e kanë mbaruar shkollën e mesme nuk dinë asnjë fjalë të gjuhës tjetër", u shpreh gazetari Todor Pendarov.



Implemented by **giz** German-Germany Cooperation

Programme: Sustainable Regional and Economic Development, Employment Promotion and VET

Programme: Sustainable Regional and Economic Development, Employment Promotion and VET
The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The objective of the programme reads: "The employment situation for employees and self-employed, especially qualified young people, is improved." The programme follows a nation-wide approach. It has four fields of activity: (i) Vocational Education and Training, (ii) MSME Promotion, (iii) Social Initiatives and (iv) Investment Promotion & Policies and Strategies for Employment Promotion.

The component, "Vocational Education and Training" (TVET), aims to enhance the quality of vocational training and education and bring it closer to match the labour market demands. Thus it contributes to the implementation of the National Employment and Skills Strategy (NESS 2014 – 2020), focusing on the Strategic Priority A: "Foster decent job opportunities through effective labour market policies" and Strategic Priority B: "Offer Quality vocational education and training for youth and adults".

The second area of action, "Promotion of micro, small and medium-sized enterprises" (MSMEs), aims at building MSMEs capacities to generate economic growth with positive effects in employment, with an eye on improving growth conditions that have an impact on employment and the increase of supply and demand for skilled workers. To that end, the programme will cooperate with clusters of micro, small and medium-sized enterprises, as well as with the business representative associations.

The third area of action, "Social participation of youth and minorities", aims to support civil society social initiatives, focusing on the marginalized youth and teenagers.

The fourth area of action, "Strategies and frameworks for regional development, economic growth and employment", aims at enhancing conditions for the implementation of relevant strategies and projects within selected ministries and their subordinate institutions, like, for example, the Business and Investment Development Strategy 2014 – 2020, and the National Employment and Skills Strategy (NESS 2014 – 2020). The programme will play an advisory role on the cross-cutting issues of the first and second areas of action, with particular focus on employment-related issues.

ProSEED builds on the integration of three previous projects, „Vocational Education and Training (Jan 2015 – Dec 2016)“, „Increasing the competitiveness of MSMEs by promoting innovation and entrepreneurship (ProSME, Oct 2014 - December 2016)“, and „Economic Good Governance for Improving the Investment Climate“ (Mar 2015 - Feb 2017). While the three forerunning projects covered certain segments in the area of promoting economic growth and employment (from the perspective of the labour offer, labour market demand and general conditions) through isolated interventions, the new programme intends to advance the approach applied so far and extend its scope by way of including new approaches aimed at employment promotion. In this context, the activities are complementary and favour a better matching of labour supply and demand match. The programme overall term is three years, starting from January 2017 until December 2019 (three years).

The programme contributes to reducing structural unemployment and underemployment, and to meeting the demands of the private sector with skilled workers. In this way, it tackles a thematic area of particular relevance to Albania and its further social and economic development.

GIZ Office Albania seeks the following staff:

Programme Coordinator: Synergies between VET and Entrepreneurship

A. Responsibilities

The incumbent holds autonomous responsibilities for his/her field of intervention in the implementation of ProSEED. The Programme Coordinator is responsible for:

- Management of programme activities according to programme goals, operational planning and agreements with the partner structure, namely the Ministry of Finance and Economy and subordinate agencies. This implies planning, budgeting, implementation and contribution to monitoring of measures as well as provision of advice to partners in close coordination with the leadership of the programme.
- This entails the management of two intervention areas (i) provision of VET through private training providers and (ii) provision of entrepreneurship trainings. In both cases, the trainings are delivered by external institutions/experts but are to be accompanied and coordinated by the incumbent.
- The incumbent will foster the realization of synergies amongst two components of the ProSEED programme, namely VET and Private Sector Development. Fostering exchange of concepts, coordination at participants' & geographical level and creating innovative ideas on how to exploit synergies amongst the components (also including the work with socially disadvantaged youths).

- Contributions to knowledge management, monitoring and PR of ProSEED.
- Management of GIZ tasks as assigned per need.

The Programme Coordinator performs the following tasks:

B. Tasks

1. Management and Coordination tasks

- Manages program activities according to program goals, operational planning and agreements with the partner structures. This implies planning & budgeting, implementation and monitoring of measures within and may entail the accompaniment of external experts. The focus is on work with private training providers and on entrepreneurship trainings.
- Leads on calls for proposals on private training providers and ensures the smooth implementation of measures providing high-quality trainings and both their quantitative and qualitative monitoring.
- Accompanies the entrepreneurship trainings under the CEFE-methodology and ensures both quantitative and qualitative monitoring.
- Conceptualises the exploitation of synergies between VET and entrepreneurship and facilitates their exploitation.
- Accompanies the financial and administrative issues regarding the assigned intervention areas in close coordination with the contract manager of the programme.
- Conceptualises, prepares and implements workshops, seminars, and other events on subjects that are related to the program's field of activities.

2. Communication and networking

- Assists GIZ-Programme Director in establishing and increasing ProSEED visibility among stakeholders for VET and entrepreneurship;
- Actively networks on behalf of GIZ in the relevant community;
- Communicates and channels local interests and aspirations and exchanges ideas and information for the benefit of the programme.

3. Knowledge management

- Assist in improving the program's knowledge management system and tapping into other knowledge management systems;
- Compiles information about ongoing programme activities and ensures knowledge transfer and link-ages' exploitation especially among the ProSEED team;
- Prepares appropriate input to the various program reports/publications including annual reports; con-tributes to other reports required by the AV and the GIZ Headquarter

C. Required qualifications, competences and experience:

- Master's degree in Economics, Education, Social Sciences, Business Administration, or other relevant field.
- Work experience with regards to VET and entrepreneurship/MSME-support.
- Minimumally 5 years of professional working experience in a similar position related to VET and entrepreneurship/MSME-support.
- Strong record of professional expertise in his/her field
- Excellent command of MS-Office
- Good working knowledge of modern telecommunication systems
- Language skills (must include Albanian & excellent spoken and written English)

Contract conditions:

- Full-time employment
- Programme office in Tirana
- Assignment period: until 31.12.2019

Please forward your application until **10th of December** to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de including the following information: Application letter, CV in English (Europass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

BOTIMI

Ardian Vehbiu:

Mëri alfabetesh, polemikë për disa keqkuptime me alfabetin e Stambollit

Libri më i fundit i Ardian Vehbiut, "Fjalë për fjalë", i botuar nga Botime Çabej nën kujdesin e Brikena Çabej, gjendet në librari prej mesit të nëntorit. Ai u promovua në mjediset e Institutit Çabej në Tiranë pak ditë më parë me një diskutim rreth librit, të udhëhequr nga Ardian Vehbiu, Eda Derhemi dhe Ledi Shamku si dhe pyetjet e shumë lexuesve dhe dashamirësve. Gjithashtu Elona Pira dhe Ardian Vehbiu rrëfyan shkurt rrugëtimin e "Peizazhe të fjalës", për t'i lënë vendin tingujve planistik të Beethoven, interpretuar nga Mikaela Minga. Prej librit më të ri, po shkëputim një copëz.

Nga Ardian Vehbiu

Rastësisht, duke kërkuar të dhëna për Kongresin e Manastirit, të vitit 1908, ndesha në faqen përkatëse të Wikipedias shqipe. Kongresi në fjalë u mbledh për të vendosur se me ç'alfabet do të shkruhej tash e tutje gjuha shqipe; ose për të zgjedhur midis alfabetëve të ndryshme të shqipes që qarkullonin në atë kohë. Mes alfabetëve ekzistues, shumë autorë të Rilindjes Kombëtare, sidomos ata me prejardhje nga Jugu, kishin bërë të vetin të ashtuquajturin Alfabet të Stambollit, i cili përdorte një bazë latine, të plotësuar me një numër shkronjash jolatine – greqishte dhe cirilike. Krahas Alfabetit të Stambollit, për të shkruar shqipën përdorehin edhe alfabetë të tjera, mes të cilave më të rëndësishmit ishin ato me bazë tërësisht latine të shoqërive katolike "Bashkimi" dhe "Agimi" në Shkodër.

Më parë shqipja ishte shkruar edhe me alfabetin grek, alfabetin arab, ose alfabetë origjinale, të shpikura prej autorëve individualë. Megjithatë, nga të gjitha këto alfabetë, vetëm dy konkurronin seriozisht mes tyre – ai i Stambollit, dhe alfabeti me shkronja thjesht latine. Pas shumë diskutimesh, Kongresi i Manas-

tirit vendosi që ta lërë të hapur çështjen e njësimt të alfabetit, duke i pranuar të dy alfabetet si të përshtatshme për shqipën. Ishte një vendim kompromisi, që i hapi rrugë imponimit të alfabetit thjesht latin, meqë ky ishte më i thjeshtë dhe tipografikisht më i volitshëm si ai i Stambollit. Të gjitha këto, janë njohuri elementare, të cilat mund t'i gjesh në çdo tekst historie.


Prandaj u çudita tek lexova, në Wikipedia, se: Kërkesa e kombëtaristëve shqiptarë ishte që gjuha shqipe të mos shkruhej as me shkronja arabe, as me shkronja greke, por me alfabetin latin, gjë që nënkupton mosnënshtrimin qoftë ndaj omanëve, qoftë ndaj grekëve. Kongresi vendosi me votë unanime të lënë mënjanë alfabetin e Stambollit, dhe ta shkruanin gjuhën shqipe vetëm me alfabetin latin me 36 shkronja dhe që përdoret deri më ditët tona. Ky informacion jo vetëm është i gabuar dhe kumton, në thelb, të kundërtën e çfarë vendosi Kongresi, por edhe lë të kuptohet sikur Alfabeti i Stambollit i përket njëfarësoj traditës së të shkruarit të shqipes me shkronja jolatine.

Kësajosi, zëri i Wikipedias në vend që të informojë, hap-tazi dizinformon; dhe e bën këtë jo nga padija. Në fakt, në bibliografinë e faqes, citohet edhe vepra e mirënjohur e Sh. Demirajt dhe K. Priftit, për Kongresin e Manastirit, në të cilën këto punë janë sqaruar mirë dhe krejt ndryshe nga ç'tuhet në artikull. M'u kujtua, në këtë kontekst, që para disa kohësh, edhe shkrimtari Albri Brahusa, në një artikull të vetin, pat shkruar ndër të tjera:

"Due me permendë faktin se në Manastir me 1908, prej Mjedës dhe Fishtës asht ba një luftë e madhe që gjuha shqipe me përdor germa latine. Kjo u arrit dhe do ta ndante përfundimisht gjuhën shqipe dhe Shqipinë prej ndikimeve turke, greke apo cirilike".

Ky paragraf, nga mënyra siç është formuluar, lë të kuptohet se ishte krahu katolik i Rilindjes Kombëtare, që luftoi për alfabetin latin të shqipes. Në fakt – dhe kjo duhet mbajtur parasysh mirë. Alfabeti i Stambollit

Libri "Fjalë për Fjalë"- Eksplorime në hapësirat e shqipes i botuar nga "Çabej"



Ardian Vehbiu

është alfabet MBI BAZË LATINE, i plotësuar me disa shkronja greke dhe cirilike, të cilat përdoren për të shenjuar ato fonema të shqipes që nuk kanë përgjegjëse të drejtpërdrejta në alfabetin latin.

M'u kujtua pastaj edhe një artikull i K. Myftarajt, ku autori e quante Alfabetin e Stambollit "të turpshëm", për shkak të shkronjave greke dhe sllave që përdoren aty, dhe pastaj vërente me delikatesën karakteristike: *Ata që i imponuan gjuhës shqipe alfabetin me gërma greke dhe me cirilica, morën mbi vete turpin e historisë dhe vepra e tyre u mbulua në varrezën e turpve të historisë shqiptare.*

Me sa duket, ekziston një rrymë e nëndheshme në mendimin shqiptar bashkëkohor, e cila po ia mban për faj të madh Alfabetit të Stambollit shkronjat jolatine që ka pranuar – duke harruar rolin që ka luajtur ky alfabet gjatë Ril-

indjes Kombëtare, librat që janë shkruar me të, autorët që e kanë krijuar dhe autorët e tjerë që e kanë përdorur.

Siç mund të pritej, dizinformimi i faqes në Wikipedia është përcjellë edhe në faqe të tjera të Internetit shqip, të cilat njëllon flasin për hoxhën që ka përgafuar Gjergj Fishtë në Kongres dhe për vendimin e atjeshëm që të "lihej mënjanë" Alfabeti i Stambollit. Një shpifje-lajthitje, e shumëzuar deri në marrëzi, falë papërgjegjësive brutale të Internetit shqip.

Si do ta shpjegojmë këtë mllaf gati histerik ndaj Alfabetit të Stambollit, me të cilin janë shkruar jo vetëm veprat themelore të Rilindjes Kombëtare, por edhe tekstet shkollore dhe abetaret e shkollave të para shqipe; dhe që, pa pikë dyshimi, është pjesë konstitutive e Rilindjes Kombëtare? Në sipërfaqe, duket sikur mllafi ka të bëjë me ato pak shkro-

nja jolatine që përmban alfabeti; por mllafi për shkronjat jolatine shumë lehtë mund të shndërrohet në një vegël për të stigmatizuar dhe minimizuar komponenten jugore (toske) të Rilindjes, në emër edhe të një revanshi katolik në kulturën kombëtare. Për kureshtarët, po sjell këtu më poshtë një tabelë përmbledhëse të shkronjave të Alfabetit të Stambollit.

Ja edhe si i shpjegon vetë Sami Frashëri arsyet e përdorimit të shkronjave jolatine në Alfabetin e Stambollit: Vërtet shkronjat e latinishtes janë aqë të pakta, sa jo për gjuhët tënë, që ka kaqë zërra, po edhe për gjuhërat e Evropësë nuk janë mjaft. Evropianët për të mbushur ato të pakatë, shkruajnë nga dy shkronja, e i këndojnë të dyja bashkë, po kjo është një punë e rëndë e mërziurë. Kësaj i desh gjendurë një udhë. Përmi këtë shumë njerëz janë menduarë edhe shumë udhëra kanë

gjeturë, po nonjë nukë ka qën' e leht' e e pëlqyerë sikundrë duhetë. Këtë herë që u duk nevojt' e madhe për të shkruarët e të gjuhësë sanë, këtë her' u gjentë edhe një udhë shumë e lehtë' edhe shumë mirë: Muarrmë të njëzet e pesë shkronjatë latinishtë, u dhamë cave nga ato një këndim pas nevojës së gjuhësë sanë, edhe nga të njëmbëdhjetat' e tjera ca i bëmë prapë nga ato shkronja, duke ndërruarë pak fytjyrënë, ca i muarrmë nga greqishtja, që është' edhe ajo një nga motërat e vjetëra të gjuhësë sanë, si edhe latinishtja.

Xhevat Lloshi vëren se argumentimi i mësipërm i Sami Frashërit është i saktë teknikisht, por jo deri në fund bindës, sa kohë që mangësitë e alfabetit thjesht latin mund të plotësoheshin edhe nëpërmjet përdorimit të shenjave diakritike (p.sh. ë, ö, i, ç, ñ, etj.) sikurse edhe veprohet, në dy raste, me alfabetin e sotëm të shqipes; prandaj, zgjedhja e shkronjave greke, përkatësisht sllave, nuk do të ketë qenë e diktuar thjesht nga rrethanat teknike dhe tipografike. Sipas Lloshit, në të vërtetë:

Alfabeti i Stambollit ishte një zgjidhje kompromisi, një kompromis që theksohej duke e quajtur "alfabet kombëtar." Ai ishte hapi i fundit, përpara se të arrihej shkëputja vendosmërisht nga alfabeti grek.[po aty, f.

KATOLIKËT DHE SAMI FRASHERI

Po cili ishte roli i katolikëve shqiptarë në këtë mes? Katolikët luajtën rolin e tyre, me virtuozitet, veçanërisht gjatë Kongresit të Manastirit dhe më pas; por gjithnjë nuk duhet harruar se fatet e Rilindjes Kombëtare vendoseshin në Stamboll, në Bukuresht, në Sofje dhe në Kairo; dhe se katolikët si forcë propretimore dhe alfabetit latine të përdorura prej tyre nuk dihet të kenë pasur ndonjë farë ndikimi, sado minimal, në adoptimin e bazës latine të Alfabetit të Stambollit nga krijuesi i tij, Sami Frashëri.



167] Ky autor vëren se Alfabeti i Stambollit “përgjithësisht nuk u ndoq në Veriperëndim të vendit”, ndërsa gjeti mbështetje të madhe në Shqipëri dhe mesme dhe veçanërisht te bejlerët dhe myslimanët e Tiranës. Në fund të shekullit XIX, turqishtja ende shkruhej me alfabetin arab, por kjo do të ndryshonte me reformën e mbështetur fort nga Atatürk, në vitet 1920-1930. Alfabeti i ri, me shkronja latine dhe shenja diakritike, do t'i shërbente një qëllimi të dyfishtë: koagulumit të identitetit kombëtar turk si të ndryshëm nga identiteti osman dhe afrimit të kulturës kombëtare turke me Perëndimin dhe Europën. Të dyja këto qëllime i mishëronte, jo rastësisht, edhe Alfabeti i Stambollit për shqipen, i pesëdhjetë vjetëve më parë.

Studuesi Geoffrey Lewis, vëren se alfabeti i Stambollit, i krijuar dhe i promovuar nga Shqipëria e të Shtypurit Shkronja Shqip, ka ndikuar, tërthorazi, edhe në reformat që përfshinë çdo aspekt të turqishtes, në fillim të shekullit XX, me synim evropianizim e saj.

Pa e specifikuar me emrin e vet si Alfabet i Stambollit, ai përmend alfabetin me 36 shkronja “latine dhe greke” që sipas tij Sami Frashëri dhe vëllai i tij Abdyl Frashëri kishin krijuar, për gjuhën e tyre amtare, shqipen – një gjuhë, thotë ai, së cilës alfabeti arab i rrinte

syet që e mbanin të gjallë, veç nevojës për “oksidentalizim” që ndihej prej elitave laike në Stamboll, kishte të bënte edhe me mangësitë e mëdha dhe të gjithanshme të alfabetit arab, me të cilin shkruhej osmanishtja; të njëjtat mangësi që do të kenë luajtur rolin e tyre për të bindur shumë shqiptarë të fesë islame që të përqafonin shkronjën latine për shqipen. Për ta kuptuar këtë, mjaft të kemi parasysh se ndërrimi i alfabetit të turqishtes donte të thoshte edhe se, që nga ai moment, turqit me shkollë nuk do të mund të lexonin më Kuranin; megjë, siç vëren gjithnjë Lewis, shumica e njerëzve, edhe e atyre që flasin më shumë se një gjuhë rrjedhshëm, zakonisht nuk mësojnë dot më shumë se një alfabet në jetë. Prandaj, për Turqinë, sikurse për shqiptarët myslimanë gati gjysmë shekulli më parë, adoptimi i shkronjave latine ishte njëkohësisht edhe një hap i guximshëm përpara, drejt laicizimit të kulturës dhe, për pasojë, edhe të jetës sociale. Në një kuptim, mund të thuhet se shqiptarët e Shoqërisë së Stambollit, e cila operonte në një mjedis kulturor osman, u treguan turqve se ISHTE E MUNDSHME që një gjuhë të fillonte të shkruhej me një alfabet të shquar posaçërisht për të, ose të krijuar në epurvetë.

Natyrisht, shumë prej intelektualëve turq, mes të cilëve edhe ata që e përshëndetën nisnëm e vëllezërve Frashëri dhe ua sollën bashkatdhetarëve si shembull të një reforme të suksesshme, nuk e dinin, as mund ta dinin, se shqipja në fakt e kish të njëjtin traditë të veten të vjetër, të shkrimit me alfabetin latin – atë të shkrimtarëve të vjetër katolik të Veriut, së bashku me atë tjetrën, jo më pak të rëndësishme, të arbëreshëve të Italisë. Ndikimi, sado i tërthorë, i Shoqërisë së Stambollit në frymëzimin dhe suksesin e reformës alfabetike të turqishtes është për t'u vënë në dukje; sidomos në kontekstin e paralelizmave të tjera, që ende mbeten për t'u përkshuar mirë, në ecimin e shqipes, përkatësisht turqishtes moderne, gjatë shekullit XX. Një qasje të re ndaj interpretimit të Alfabetit të Stambollit e gjejmë në studimin e Frances Trix, me titull “Alfabeti i Stambollit i Shemshedin Sami Beut: Pararendësi i reformës turke të shkronjave”.

Siç duket qartë që në titull, autorja i vendos përpjekjet për t'i dhënë një alfabet shqipes në marrëdhënie me përpjekjet, të cilat do të kurorëzoheshin mjaft më vonë, për t'i dhënë një alfabet latin turqishtes-osmanishtes. Sami Frashëri, autori i Alfabetit të Stambollit, ishte në fakt edhe një nga dijetarët që më

“
Me sa duket, ekziston një rrymë e nëndheshme në mendimin shqiptar bashkëkohor, e cila po ia mban për faj të madh Alfabetit të Stambollit shkronjat jolatine që ka pranuar – duke harruar rolin që ka luajtur ky alfabet gjatë Rilindjes Kombëtare

shumë ka kontribuar në emancipimin e kulturës osmane dhe lindjen e kulturës dhe të gjuhës turke, si kulturë dhe gjuhë kombëtare.

Studuesja Trix përmend pastaj faktin që, deri edhe gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX, nuk kishin munguar përpjekjet për t'i dhënë shqipes një alfabet jo të mbështetur në modelet ekzistuese dhe tipografikisht të përdorshme (latin, grek, cirilik, arab), por krejtësisht origjinal, oka do të krijonte vështirësi teknike të pakapërcyeshme, për një lëvizje si Rilindja Kombëtare, që shqipen e shkruar kërkonte ta përdorte si mjetin kryesor për kulturimin e popullit.

Kështu, pas Naum Veqilharxhit, që kish krijuar një alfabet të vetin dhe një abetare me këtë alfabet në vitin 1844, edhe Hoxha Tahsini kishte krijuar një alfabet origjinal për shqipen, me shenja të ngjashme me gjeorgjishten.

Shkruan Trix: Në tabelën që Tahsini përdori për të paraqitur alfabetin e tij, gjuhët e tjera referuese, nga e majta në të djathtë, ishin: turqishtja osmane, frëngjishtja, greqishtja, bullgarishtja, armenishtja dhe më pas alfa-

“
Milefi për shkronjat jolatine shumë lehtë mund të shndërrohet në një vegël për të stigmatizuar dhe minimizuar komponenten jugore (toske) të Rilindjes

beti i tij i ri shqip.

Autorja vazhdon duke pyetur, me të drejtë, se ç'kërkonte armenishtja në këtë grup, në një kohë që ishte një gjuhë me të cilën shqiptarët s'kishin pasur ndonjëherë marrëdhënie; dhe sidomos, pse është vendosur armenishtja kaq afër alfabetit të ri të shqipes. Këtu Trix-it i hyn në punë një raport i një komisioni të ngritur nga Osmanli Maarif Nezareti (Ministria Osmane e Arsimit) dhe i botuar në vitin 1869, që rekomandonte një alfabet për gjuhën shqipe “sepse akoma nuk ka një shkrim të posaçëm për shqipen.”

Në fakt, thotë ajo, ekzistonte në atë kohë një model kulturor “osman”, sipas të cilit NJË SHKRIM I DALLUESHËM ISHTE SHPREHJE E NJË POPULLI TË DALLUESHËM. Përsëri Trix: [M]ë 1831, në numërimin e popullsisë osmane, kategoritë ishin: myslimanët; rajatë; që përbëheshin në pjesën më të madhe prej ortodoksëve dhe katolikëve; romët; çifutë dhe armenët. Përveç romëve, secili prej këtyre grupeve kishte shkrimin e tij të veçantë.

Më 1881, në numërimin e përgjithshëm të popullsisë osmane, kategoritë ishin: myslimanët, grekët, armenët, bullgarët, katolikët, çifutët, protestantët, latinët (katolikët europianë), sirianët, romët jomyslimanë dhe të huajt. Kategoritë kryesore, d.m.th. gjashtë të parat, të gjitha kishin shkrimet e tyre. Kriteri kryesor në numërimet e viteve 1831 dhe 1881 është dukshëm feja. Por shkrimet e veçanta në shumë raste përkonin, duke shërbyer kështu si embleme e grupit. Ajo që kërkonim në shumë patriotët shqiptarë në shekullin XIX ishte që të njiheshin si popull dhe si një njësi, si një bazë për t'i qëndruar gjithënjë të tokave shqiptare prej fqinjëve. Kategorizimi osman i popujve sipas fesë dhe grupit fetar-etnik shkonte kundër shqiptarëve me shumë fe, sikundër edhe ndarja administrative osmane e zonave me popullatë shqiptare në katër vilajete.

Unë e shoh alfabetin e Stambollit të Sami beut si një afrim drejt qëllimit të “alfabetit të veçantë”, për të simbolizuar veçantësinë e shqiptarëve si një popull në Ballkan dhe në kontekstin më të gjerë osman. Por, me teknologjinë e shtypshkronjave të kohës, veçantia mund të vinte në mënyrë më praktike prej përzjerjes së veçantë të shkronjave të disponueshme, sesa prej një alfabeti vërtet të veçantë. Arsyetimi tingëllon bindës. Pamja disi “hibride” e Alfabetit të Stambollit ka qenë, në këtë rast, rezultat i një përpjekjeje të qëllimshme për t'u shmangur sado pak alfabetit latin, në emër të përfuturit të këtij shkrimi

unik, origjinal, të veçantë për shqipen, të tillë që do të lehtësonte NJOHJEN E SHQIPTARËVE SI POPULL MË VETE brenda Perandorisë Osmane. Alfabeti thjesht latin, në kontekstin e Perandorisë, shërbente si shenjë dalluese e katolikëve, të gjithë katolikëve pavarësisht nga kombësia – në një kohë që shqiptarët nuk mund të njiheshin si popull i veçantë më bazë fetare. Vite më vonë, kur i erdhi radha Kongresit të Manastirit, rrethant historike kishin ndryshuar dhe Stambollit po venitej si qendër e botës, veçanërisht për shqiptarët. Edhe pse pjesëmarrësit në Kongres nuk mund të shpërfillnin prestigjin që kishte arritur Alfabeti i Stambollit brenda atyre pak dekadave që ishte përdorur, ata ishin në gjendje të vinin re se alfabeti vetë, në trajtat që kishte, me shkronjat e përziera, ishte një artefakt përfaqësues i një epoke tashmë të kapërcyer. Gjydhja e kompromisit, për t'i lënë të dy alfabetet në fuqi kraher kraher, ishte zgjidhje e urtë dhe e respektueshme ndaj përpjekjeve kulturore të Rilindjes Kombëtare gjatë shekullit XIX. Si zgjidhje, ajo sanksiononte de facto alfabetizimin latin të shqiptarëve, siç edhe ndodhi; dhe kjo zgjidhje – të mos harrojmë – u bë e mundur vetëm nga largpamësia e Sami Frashërit, i cili i kish të dhënë Rilindjes Kombëtare një alfabet të tillë që, sado i përzjer dhe pjesërisht jolatine, të lejonte pa shumë vështirësi praktike, tipografike dhe psikologjike kalimin drejt sistemit tërësisht latin.

Po cili ishte roli i katolikëve shqiptarë në këtë mes? Katolikët luajtën rolin e tyre, me virtuozitet, veçanërisht gjatë Kongresit të Manastirit dhe më pas; por gjithnjë nuk duhet harruar se fatet e Rilindjes Kombëtare vendoseshin në Stamboll, në Bukuresht, në Sofje dhe në Kairo; dhe se katolikët si forcë propretimore dhe alfabetit latine të përdorura prej tyre nuk dihet të kenë pasur ndonjë farë ndikimi, sado minimal, në adoptimin e bazës latine të Alfabetit të Stambollit nga krijuesi i tij, Sami Frashëri. Prandaj një kontributin e katolikëve në çështjen e alfabetit do ta shihja pikërisht dhe kryesisht këtu: kur Perandoria Osmane mori tatëpjetën dhe Alfabeti i Stambollit i humbi arsyet që e mbanin të gjallë me gjithë artificialitetin strukturor që ngërthente në vetvete, atëherë katolikët e patën gati, të ruajtur, të përpunuar dhe të kolauduar, alfabetin thjesht latin të shqipes që do të zëvendësonte atë të Stambollit. Kalimi aq i rrjedhshëm nga një alfabet në tjetrin, megjithatë, nuk do të realizohej dot, sikur të mos kish pasur Alfabeti i Stambollit bazë latine ai vetë.

DPSHTRR: Detyrimet që fshihen, si të kryeni verifikimin nga targat

FSHIRJA E DETYRIMEVE

Subjektet që duan të mbajnë mjetin në qarkullim u fshihen detyrimet tatimore për periudhat dhjetor 2010 e më parë, me kusht që të paguajnë detyrimet për periudhën janar 2011 e në vijim, me përjashtim të gjobave për mospagesë së taksave të periudhës janar 2011 deri në dhjetor 2014, të cilat fshihen/shuhen me kushtin e pagesës së të gjitha detyrimeve të plota", thuhet në njoftim DPSHTRR.

Ornela Manjani

Drejtorja e Shërbimit të Transportit Rrugor ju kujton drejtuesve të mjeteve që kanë detyrime të paslyera se kanë afat deri në 31 dhjetor për të përfunduar amnistia. Zbatimi i ligjit "Për pagesën dhe fshirjen/ shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore", ka hyrë në një fazë të rëndësishme. Kështu thotë në një njoftim të fundit, Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, ku thekson se procedurat mund të

Amnistia për makinat, afati deri në 31 dhjetor

Janë 140 mijë automjete që përftojnë nga falja

ndiqen deri më datë 31 dhjetor 2017. "Brenda datës 31.12.2017, njoftohen të gjithë qytetarët që të përfitojnë nga procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/

shuarjes së detyrimeve. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka publikuar dhe azhurnuar listën e mjeteve objekt i ligjit 33/2017, ku të gjithë personat e interesuar

mund të bëjnë verifikimin e targës dhe karakteristikave të tjera të mjetit në këtë listë. Subjektet e personat përgjegjës të paraqiten pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transpor-

tit Rrugor për të kryer pa pagesë, veprimet e heqjes nga qarkullimi të mjetit apo për të kërkuar moskryerjen e procedurës së heqjes nga qarkullimi dhe mbajtjen aktiv të tij.

TARGAT E MJETEVE QË KANË DETYRIME TË PASHLYERA

Table with 10 columns of license plate numbers (TARGA) and corresponding vehicle identification numbers (VIN).

E DIEL
26 Nëntor
2017



Në prag të vitit të Skënderbeut

Cilët ishin vëllezërit Gazulli, ambasadorët e Skënderbeut

NGA GJON MARKU

Mirdita ishte një ter ritor në të cilin vazhdonin të sundonin princërit dhe drejtues e krerë popullorë, të cilët kishin bërë të mundur që falë së drejtës zakonore dokësore të kishin mëvetësinë dhe nuk e lejonin pushtimin e kësaj treve.

Por shpërthimi i luftërave çlirimtare nuk ishte i lehtë në kushtet kur mungonin gjërat kryesore, pra bashkimi i popullit dhe armët. Për të siguruar këto u organizuan njëri pas tjetrit kuvendet panshqiptare e ndërballkanike, të cilët kërkonin të arrinin bashkimin e popullit në luftë kundër osmanëve. Kuvendet e pleqve ndër këto

vise tashmë ishin një traditë e kahershme ku miratoheshin projektet e luftërave. Krerët popullorë, pleq të maleve tona, pasi shqyrtonin këto situata dhe situatën jashtë trevave të tyre, u drejtoheshin Fuqive të Mëdha për ndihmë.

Por prej kësaj tradite dhe prej këtij trualli vinin dhe humanistët, dijetarët dhe ambasadorët e mëdhenj të Gjergj Kastriotit vëllezërit Gazulli, origjina e të cilëve është Mirdita edhe pse jeta

dhe veprimtaria e tyre lidhet fort me Raguzën, Padovën me qytete të tjera të Dalmacisë dhe të Italisë, apo Evropës. Ata zenë vend të rëndësishëm në Rilindjen Evropiane.

Vetë koha kur jetuan gazullorët bën që për ta të ketë të dhëna të ndryshme e shpesh jo të plota edhe për faktin se akoma institucionet studimore e shkencore të vendit tone, nuk janë angazhuar ndaj tyre me vëmendjen dhe përkushtimin e duhur. Kësh-

tu akoma nuk është dokumentuar data e plotë dhe e saktë e lindjes së humanistit të madh Gjon Gazulli. Hipoteza të ndryshme ka dhe për vendin se ku lindi. Ka studiues të ndryshëm ndonjëherë jo fort seriozë qoftë këta vendas por edhe të huaj, që për qëllime të ndryshme, vend-origjinën e tyre e spostojnë herë pas here duke krijuar një lutim dhe pëshënjim aspak serioz dhe të panevojshëm.

Po t'u referohemi dokument-

eve historike që disponojmë dhe që njihen deri më sot, atëherë ka vetëm një vend origjine të kësaj familjeje fisnike dhe aristokrate e ajo është Mirdita. Askund tjetër nuk gjendet asnjë lloj dokumenti bindës që ta spostojnë vend-origjinën e kësaj familjeje.

Origjina e hershme e gazullorëve ishte nga Mirdita, shkruhet ndër dokumente, ku deri vonë janë ruajtur disa mbishkrime me këta emra ndër varrezat e Ndërfanës.

→ Vizion në faqen 14

D

DOKUMENT

Prej traditës mirditore dhe prej këtij trualli vinin dhe humanistët, dijetarët dhe ambasadorët e mëdhenj të Gjergj Kastriotit, vëllezërit Gazulli, origjina e të cilëve është Mirdita edhe pse jeta dhe veprimtaria e tyre lidhet fort me Raguzën, Padovën me qytete të tjera të Dalmacisë dhe të Italisë, apo Evropës. Ata zënë vend të rëndësishëm në Rilindjen Evropiane. Vetë koha kur jetuan gazullorët bën që për ta të ketë të dhëna të ndryshme e shpesh jo të plota edhe për faktin se akoma institucionet studimore e shkencore të vendit tonë nuk janë angazhuar ndaj tyre me vëmendjen dhe përkushtimin e duhur, na referon autori...

Cilët ishin vëllezërit mirditorë Gazulli, humanistë, dijetarë dhe ambasadorë të Skënderbeut

NGA GJON MARKU

Vijon nga faqja 1

“Te Kisha e Ndërfandënësë, ndë Mirditë, ku duket kje edhe një mungadë Benediktinësh u gjete në rrasa vorresh të shkrueme latinisht me mbiemnin: Gasolus shkruhet në revistën prestigjioze “Hyllin e Dritës”.¹

“Familja e Gazullorëve njihet si një ndër më të vjetrat, në Shqipërinë Veriore. Nga trunghi i saj vetëm një pjesë e vogël u shpërngul jashtë atdheut, pasi, sipas dokumenteve, ata i gjejmë të përhapur në Shqipëri edhe pas pushtimit osman të vendit”. Për origjinën e hershme të kësaj familjeje nga Mirdita, shkruan edhe studiuesi i mirënjohur Mikel Prenushi në librin e tij “Kontributi

sonalitet politik i shquar, paraprakisht plejadën e humanistëve shqiptarë të shekujve 15-të, 16-të dhe është padyshim një ndër shembujt e gjallë të gjenisë krijuese të popullit tonë në fushën e shkencës”.⁴

Këtij mendimi i qëndron edhe Prof. Dr. Pal Nikolli, i cili shkruan se: “... Nuk kemi akoma një njeri më të ditur se ai, një njeri me kaq zemër e kaq të zot. S’kemi ç’bëjmë duhet t’ia plotësojmë kushtin Gjon Gazullit...” këto fjalë të një zyrtari plak të këshillit të madh të Raguzës për matematikanin, astronomin e mbi të gjitha atdhetarin e flaktë Gazulli nga Ndërfana e Mirditës. Gjon Gazulli, u bë shkak për të shkruar diçka mbi këtë personalitet të shkencës dhe kulturës shqiptare dhe për vëllezërit e tij – Palin e Andrian.⁵

Por sa më shumë të mbështet

Për Gjon Gazullin

Për Gjon Gazullin dokumentacioni historik i pasur i arkivave të huaja (Itali, Kroaci, Hungari) etj. si dhe literatura historike e botuar për të, që në shekullin XVI, edhe pse është mjaft e gjerë nuk është e njohur sa dhe si duhet sidomos në vendin tonë, ku akoma botimet dhe studimet për familjen e Gazullorëve, për humanistët e mëdhenj janë të pakta dhe jo të plota. Akoma nuk kemi të ndriçuar të plotë portretin e këtij kolosi as për veprimtarinë politike, e diplomatike as si pedagog apo si shkencëtar i shquar dhe mbi të gjitha, as si patriot që vuri gjithë energjitë e veta në shërbim të çështjes shqiptare.

shqiptar në Rilindjen Europiane” botuar nga shtëpia botuese “8 Nëntori” Tiranë, 1981.² Ky është dhe studimi më i plotë që vjen deri në këtë kohë për humanistin e madh Gjon Gazullin.

Këtij mendimi i qëndron Mikel Prenushi edhe vite më vonë, pra në vitin 2002, kur botohet intervista e tij në Librin “Mirdita Intervista II”.

Në librin “Antologji e mendimit të sotmë për Mirditën” ku është ribotuar kjo intervistë dokumentohet se: “Vëllezërit Gazulli, humanistë dijetarë dhe ambasadorë të Skënderbeut ishin nga Mirdita e gjitha katolike. Këtë e pohojnë edhe dokumentet diplomatike” shkruan ky autor.³

Po ky studiuesi i mirënjohur dhe mjaft serioz qysh herët në revistën “Shkenca dhe jeta” kishte shkruar se figura poliedrike “Gjon Gazulli nga Mirdita si matematikien, astrolog, pedagog dhe per-

temi në dokumentet historike, aq më e qartë dhe më e pakontestueshme bëhet origjina e tyre prej Mirditë.

“Gazu e Gazullorë gjenden madje mjaft shpesh në Mirditë në shek. XVII e tekstej” shkruhet në revistën “Leka” në vitin 1939, nga Florio Banfi.⁶

Shqipëria e Veriut kishte njerëz të shquar dhe të arsimuar, të cilët gjendeshin ndër qytete të ndryshme ku ndër shkollat e atëherëshme ligjëronin gramatikën, moralin dhe lëndët e tjera, shkruan Milan Shufly.⁷

Vetë ai dokumenton se manastret benediktine, si ai i Rubikut, i Ndërfanës (në Gëziq), i Shënpalit (në Blinisht), i Shën Aleksandrit (në Malin e Shenjtë në Orosh) etje. në luginën e dy Faneve, nga ku në shekullin e XIV-të, siç thotë Shufly, dilnin priftërinj dhe për Dalmacinë Jugore, flasin dhe për ekzistencën e një popullsie jo të pakët



në këto anë.

Ndërkaq, në shekullin e XV kemi po ashtu njerëz të shquar dhe dijetarë si për shembull: Johannes Gazulus Ragusiensis, gjeogjësist Gjon Gazulli (1400-1465), nga Mirdita, matematikien, astronom dhe humanist i njohur në këtë shekull, i cili njihet si “mësues dhe prift i ndershëm”,⁸ shkruan në librin e tij “Krishterimi ndër shqiptarë” profesor Zef Mirdita. Po ashtu ai përmend edhe Pal Gazulli, Pavao de Gazlis i vëllai i Gjon Gazullit, që u zgjodh rektor i shkollave të qytetit të Dubrovnikut gjatë viteve 1442-1444.⁹

I këtij mendimi është edhe Fulvio Kordignjano (Fulvio Cordignano) dhe Florio Banfi; të cilët në

uesi Moikom Zeqo¹³

Duke dashur t’i afrohem sa më shumë vendlindjes së Gjon Gazullit, atëhere gjithnjë e më tepër bëhet e domosdoshme ballafaqimi i dokumentave historike e natyrishtëm shtrihet pyetja a u lind në qytetin e Raguzës, Gjon Gazulli, apo erdhi në këtë qytet në moshë fare të re?

Për t’i dhënë përgjigje kësaj pyetje duhet të marrim parasysh: Së pari: faktin se administrata raguziane e asaj kohe ishte shumë e zhvilluar, kështu që po të kishte lindur në atë qytet, me siguri do të gjendej një shënim për datën, ditën dhe vitin e lindjes së tij.

Së dyti: po t’ju referohemi disa burimeve historike, në to thuhet se ai emigroi, këtë e pohon edhe Oliver Jens Schmitt në librin “Arbëria Venedikase (1392-1479)” Ai shkruan se: Humanisti me prejardhje Arbër, sikurse astronomi i famshëm dhe njeriu i besuar i Skënderbeut Gjon Gazulli (Johannes Gazulus), nuk i gjenin dot në vendin e tyre kushtet e nevojshme materiale dhe intelektuale, ndaj dhe emigron: Gazulli do të bënte karrierë në Raguzën e pasur.¹⁴

Përpara tij, klerikë të shumtë kishin emigruar në Dalmaci dhe Itali. Kjo hemorragji mendore u shkaktua në thelb nga luftërat e shumta në hapësirën arbërore dhe nga pasiguria që sillnin ato, së bashku me bllokimin e përsëritur të jetës ekonomike. Në Arbërinë venedikase nuk është se mungonin talentet, por mungonin kushtet e favorshme të përgjithshme, vijon me tej Oliver Jens Smitt

Së treti: Shuteriqi pohon se: Gazulli, shqiptar, autoritet në Raguzë, nuk duhet të jetë pa dijeni, mbi çka zhvillohet në Mirditën e tij, ku zoti i vendit Gjon Kastrioti është thyer e nënshtruar më 1430 dhe tani e ka syun për kryengritje, në mos e ka nisur, shkruan Profesor Dhimitër Shuteriqi në librin e tij “Moti i Madh” përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479.¹⁵

“Për astronomin më të shquar, i cili ka vepruar në territorin e Kroacisë në shekullin e XV” kanë shkruar (Zh. Dadiq) Gjon Gazulli, i lindur shqiptar, i cili jetoi dhe punoi, Dubrovnik, Shime Juriqi,¹⁶



...NGA NUMRI I SHKUAR

"Milosao" e këtij numri ishte relativisht e mirë, por pak si pa shpirt. David Hosaflook na kish sjellë një dokument që konfirmonte faktin se cili ishte protestanti më i vjetër shqiptar. Flitet për Konstandin Kristoforidhin. Kohët e fundit është zbuluar një dokument befasues, i cili pohon se Konstandin Kristoforidhi është konvertuar në besimin protestant në vitin 1857. Lidhja e Kristoforidhit me protestantët nuk është

diçka e re, meqë ai ka punuar me Shoqërinë Biblike Britanike dhe për Venetë e Huaja për përkthimin e teksteve biblike, në të dyja dialektet e shqipërisë...Duke ditur peshën dhe ndihmën e këtij komuniteti për Shqipërinë do të thoshte shumë që ne ta botonim.

Preç Zogaj, shkrimtari i njohur, erdhi me ciklin e tij poetik, që ishte përbledhur në një libër, dhe që tregonte lirizmin e tij, por edhe një ngritje të vërtetë të letërsisë së tij.

Në parashkrimin e shkrimit publicistik "Kush i nëmi Bjeshtë e

Nëmuna" kishim lënë atë të numrit të shkuar. Një gabim i layout dhe një papërgjegjshmëri totale, e cila na vë sinerisht në vend të vështirë para lexuesit. I kërkojmë ndjesë publikut tonë, por na vjen keq që gabimi thjesht është kapur nga ne dhe jo nga të tjerët.

Tregimi i takonte Maks Velos dhe sinerisht jemi të kënaqur që prurja e tij ishte pëlqyer. Maks duhej të ishte pak më racional por gjetja dhe shjtella në pjesën e dytë të rrëfimit ishte e mrekullueshme.

Vazhdimi i shtepit Çukëës tash-

më preku poemën "Komunistët", ku autori gjen shumë arsye për ta futur në hulli intelektuale këtë pjesë të shkrimtarit të madh. Numri ishte relativisht i mirë dhe autori shtoi personalisht diçka lidhur me librin, për një panair që për hir të së vërtetës nuk ka shumë gjurmë.

Gabimi i layout, në faktin që përmendmë më sipër, na nxjerr dhe ne fajtoret, kurse nga ana tjetër na bën të mendojmë seriozisht që të tilla gabime nuk duhet të përsëriten.

Mirko Drazhen Grmek¹⁷, Zharko Dadiqi¹⁸ dhe Jurjo Tadiqi¹⁹ të cilët në bazë të studimeve të dokumenteve arkivore ia dolën që në vija kryesore ta ndërtojnë jetën dhe veprën e këtij të ardhuri shqiptar dhe i lindur shqiptar, i cili jetoi në Dubrovnik²⁰.

Por të gjitha këto dokumente kanë vetëm një origjinë të familjes së Gazullorëve, pra Mirditëve.

Si duket, më vonë një pjesë e tyre kanë zbritur në fushë e sidomos në fushën e Zadrëmës, përdërisa dhe në "Regjistrin e kadasërës dhe të koncensioneve për rrethin e Shkodrës" të vitit 1416-1417, ata figurojnë të shpërndarë në Barbullush, Kukël, etj. Si dhe i kanë dhënë emërin e tyre një fshat të vogël në afërsi të Velipojës.²¹

Disa nga shqiptarët në shekullin e XV kanë meritë për zhvillimin e shkencave të ndryshme. Më i rëndësishmi ndër ta është matematikani dhe astronomi, humanisti Gjon Gazulli që rrjedh prej një familjeje shqiptare, e cila kishte gjetur këtu strehim dhe punë, shkruan Jashar Rexhepagji në vitin 1968.²²

Shpërngulja e një pjese të familjes së Gazullorëve prej Mirditë për në Raguzë përmenden, së pari, në vitin 1301 në "Libër Reformatum" të Raguzës me mbiemrin Gazulus (Gazulli), Gasolo, Gazolus, Gazola, Gasolus, Gasollus. Etj. Por në dokumente të tjera gjenden dhe të shkruajtur Gasoli (Gazulli)

"Qysh në vitin 1301, në Leber Reformationum të Raguzës, përmendën do Gazullorë me mbiemnin, Gazulus (Gazulli) Gazola, Gazula" shkruhet në vitin 1942 në revistën "Hyllin e Dritës".²³

Sipas të dhënave që ruhen në Arkivin Historik të Dubrovnikut, del se në fund të shek. XV në Raguzë jetonin shumë shqiptarë të ardhur nga Shqipëria e Veriut, si dhe nga qytetet bregdetare shqiptare. Sipas Nikoll Ranjanit, i cili në një anal të vet, paraqet regjistrin e parë të bujarisë raguzjane, vërejt se nga 152 familje të bujarisë raguzjane dymbëdhjetë ishin me origjinë shqiptare, pohon Jahja Dranoqlli në librin e tij: "Gjin Gazulli astronom dhe diplomat i shekullit XV".²⁴

Por lidhjet e Gazullorëve me Raguzën datojnë që nga fundi i shekullit XIV. Pikërisht në kohën, kur në këtë qytet vjen Pal Gazulli, gjyshi i humanistit tonë. Ndërkaq, priftin at Matej Gazulli, ungjin e Gjin Gazullit në fillimin e shekullit XV, e ndeshim në qytetin e Raguzës.²⁵

Dhe po të kishte lindur këtu Gjon Gazulli pa tjetër që do ta kishin pagëzuar në kishë, dhe për të do të gjendeshin dokumente por kjo nuk e përjashton mundësinë që Gjon Gazulli në moshë shumë të



Orosh, Mirdite

Prej kësaj tradite

...prej kësaj tradite dhe prej këtij trualli vinin dhe humanistët, dijetarët dhe ambasadorët e mëdhenj të Gjergj Kastriotit, vëllezërit Gazulli, origjina e të cilëve është Mirdita edhe pse jeta dhe veprimtaria e tyre lidhet fort me Raguzën, Padovën me qytete të tjera të Dalmacisë dhe të Italisë, apo Evropës. Ata zënë vend të rëndësishëm në Rilindjen Evropiane.

re është vendosur në Raguzë të xhaxhai i tij. Këtë hipotezë e hedh edhe Jahja Dranoqlli në librin e tij për Gjin Gazullin botuar në Prishtinë në vitin 1984.

Gjon Gazulli (1400-1465) humanist, matematikani dhe astronomi i shquar shqiptar rrjedh nga një familje nga më të vjetrat e Shqipërisë Veriore nga krahina e Mirditës, një trup i të cilit ishte shpërngulur në Raguzë (Dubrovnik) aty nga fundi i shek.XIV, shkruhet në Vëllimin e parë të "Fjalorit Enciklopedik shqiptar" të botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në Tiranë, në vitin 2009.²⁶

Edhe Gaspër Gjini në librin e tij "Ishëskevia e Shkup Prizrenit nëpër shekuj" dokumenton veprimtarinë e Gazullorëve në Raguzë. "Në mes të tyre ishte Johannes Gazulus Ragusiensis (Gjon Gazulli), matematikani i famshëm, astronom dhe humanist i madh i shekullit XV përkatësisht "mësues dhe prift i nderuar"

Këtë e deklaroi dhe Juric.²⁷ Në këtë kohë është i njohur edhe Pavao de Gazlis (Pali i Gazullit) i vëllai i Gjon Gazullit, që u zgjodh rektor i shkollave të qytetit të Dubrovnikut gjatë viteve 1442-1444. Në mesin e tyre ka qenë edhe Marinus Becchichermus (Marin

Biçikerni), profesor i Universitetit të Padovës dhe dhjetë vjet rektor i Shkollës së lartë në Dubrovnik.²⁸

Këtu le të përmendim dhe artistin e famshëm Andrea Aleshin, i cili shumicën e veprave të tij të mrekullueshme i ka punuar në Dalmaci dhe në Italinë fqinje, ndërta qyteti i Splitit e ka shpallur si qytetar nderi.²⁹

Për origjinën e Gjon Gazullit nga Shqipëria, na vjen në ndihmë edhe një dokument i ardhur nga arkivat e Padovës, kur Gjon Gazulli u diplomua. Ky dokument u botua në vitin 1922 dhe e sjell të qartë origjinën e Gjon Gazullit prej Shqipërie.

"Ioannis q. Gin Gazulli de Albania..."

"Gjoni i të ndriturit Gjin Gazulli nga Shqipëria..."³⁰

Dokumentit mban datën 31 janar 1430. Në të del qartë origjina shqiptare e Gjon Gazullit, ku përpara komisionit e deklaroi veten: "Gjoni i të ndriturit Gjin Gazulli nga Shqipëria. Merita për botimin e këtij dokumenti i përket Mikel Prenushit, i cili e boton në librin e tij "Kontributi shqiptar në Rilindjen Evropiane" të botuar në Tiranë, në vitin 1981 nga Shtëpia

botuese "8 Nëntori".

Nga fundi i shekullit të XV gjëjmë të shpërngulur në Raguzë një farë Gjon Gazulli prej Arbënieje...."³¹

Nëse për familjen e Gazullorëve të shpërngulur në Raguzë gjenden dokumente të shumta nuk gjendet deri më sot asnjë dokument që të vërtetojë se Gjon Gazulli lindi në Dubrovnik. Prandaj vetë logjika dhe ballafaqimi i dokumenteve të çojnë drejt idesë se ai emigroi në moshë të vogël në Dubrovnik.

Për Gjon Gazullin dokumentacioni historik i pasur i arkivave të huaja (Itali, Kroaci, Hungari) etj. si dhe literatura historike e botuar për të, që në shekullin XVI, edhe pse është mjaft e gjërë nuk është e njohur sa dhe si duhet sidomos në vendin tonë, ku akoma botimet dhe studimet për familjen e Gazullorëve, për humanistët e mëdhenj janë të pakta dhe jo të plota. Akoma nuk kemi të ndriçuar të plotë portretin e këtij kolosi as për veprimtarinë politike, e diplomatike as si pedagog apo si shkencëtar i shquar dhe mbi të gjitha as si patriot që vuri gjithë energjitë e veta në shërbim të çështjes shqiptare.

Natyrisht Gjon Gazulli ka qenë



pa dyshim një ndër figurat më të shquara të shkencës evropiane të shek.XV. Pa frikë mund të thuhet se fushë-veprimtaria e tij ka qenë e gjerë dhe pa dyshim ai mund të quhet një enciklopedi e gjallë e kohës kur ka jetuar, përkatësisht për epokën e humanizmit dhe Rilindjes Europiane.

Literatura

1. Gelasius (pseud. i D. Nikollë Gazulli), Fjalor toponomastik: "Hyllin i Dritës" Shkodër, nr 5-10, maj tetor 1942, f. 270.
2. Prenushi, Mikel. "Kontributi shqiptar në Rilindjen Europiane" Shtëpia botuese "8 Nëntori", Tiranë 1981, f. 36.
3. Marku, Gjon. "Antologji e mendimit të sotëm për Mirditën" Tiranë 2009, f. 161.
4. Prenushi, Mikel. "Figura të shquara të kulturës e të shkencës sonë. Humanisti shqiptar Gjon Gazulli "Shkencë dhe jeta", nr. 6, 1972.
5. Nikollë, Pal. Gazeta "Ora e Shqipërisë", Tiranë, nr. 3, prill 1994, f. 3; Rilindja, Tiranë, nr. 582, 7 maj 1995, f. 7.
6. "Leka", Shkodër, nr. 1-2, 1939. (sh. Cordignano, L. Albania a trenorsa l' opera e gli accriti di un grande Missionario Italiano il P. Domenico Pasi S.J., Roma, Ist P. Eur. Orient 1934, v. III, pp. 22, 56 ARK HIST. SAVERIAN, nr. 2382-2384; "D. Shjtefen Gazullori, famullitari i Vjguit 1613-1617".
7. Acta Alb. Velli II 233; M Suflij, Povijesti sjevarnih Albanica (Sociologica studija, ne AAAJ knj II (1924 q 925, f.220).
8. Jereček, K. - Radonić, J. Istorija Srba I Beograd 1978, f 86
9. Frankovic, D. Pavijest skolstva i pedagogije u Hrvatskoj Zagreb 1958, f.22.
10. "Leka", Shkodër, nr. 1-2, 1939. (sh. Cordignano, L. Albania a trenorsa l' opera e gli accriti di un grande Missionario Italiano il P. Domenico Pasi S.J., Roma, Ist P. Eur. Orient 1934, v. III, pp. 22, 56 ARK HIST. SAVERIAN, nr. 2382-2384; "D. Shjtefen Gazullori, famullitari i Vjguit 1613-1617".
11. Dedaj, Ndue. "Toka e Katedraleve" Tiranë 1999, f. 161.
12. Berisha, Gjon. "Arbnorët ndërmjet kishës perëndimore dhe asaj lindore gjatë shekullit XIX Prishtinë 2015 f. 561; Mikel Prenushi, "Kontributi shqiptar në Rilindjen Europiane", Tiranë 1981, f. 34-39.
13. Zeqo, Moikom. "Humanisti shqiptar i Rilindjes Europiane", "Horizonti", nr 12, 1961.
14. Schmidt, Oliver Jens: "Arbëria Venedikase (1392-1479)", Fjala 2014, f. 14.
15. Shtuertij, Dhimitër. "Moti i Madh" përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479 Shtëpia botuese "Dituria", Tiranë 2006 f. 83.
16. Juric, Shime. Prilozki bibliografiji Ivana Gazulija. Abnali Historijskog Instituta u Dubrovniku, 8-9 (1960-1961), f. 447-478.
17. Grmek, Mirko Drazhen. Hrvatski sveuciliste u Padovi, Ljetopis Jazu, knj. 62, 1957, f. 353-354; Mirko Drazhen Grmek i ZhaarkoDadiqi, O astronom Gjin Gazulli o dovoavackom traktatu o astrologu. Anali Historijskog odjela Centra za zaanstveni rad Jazu u Dubrovniku, 13-14 (1976) f. 83-94.
18. Dadiqi, Zharko. Pavjestje egzakni znanosti u Hrvati i Zagreb 1962, f. 46.
19. Tadiqi, Jorjo. Johannes Gazulus, duvrovacki humanista XV veka, Zbornik filozofskog fakulteta, Beograd, 8/1964, sv2 f. 429-454.
20. Stjepovic, Aleksander. "Albanologia në Koraci - pasqyrë historike" Gjurmime albanologjike. Instituti Albanologjik i Prishtinës 21-1991, F 166.
21. Regjistrin i kadasërës dhe i koncensioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417, Tiranë,1977, f. 227, 256, 257.
22. Rezhepagji, Jashar. "Kontributi për njohjen e disa artistëve, shkrimtarëve dhe punëtorëve pedagogë shqiptarë të shekullit XV" Simpoziumi për Skënderbeun 9-12 maj 1969' Prishtinë
23. "Gelasius (pseud. i D. Nikollë Gazulli), Fjalor toponomastik: "Hyllin i Dritës" Shkodër, nr 5-10, maj tetor, 1942, f. 270.
24. Dranoqlli, Jahja. "Gjin Gazulli astronom dhe diplomat i shekullit XV" Rilindja, 1964, f. 9.
25. Dranoqlli, Jahja. "Gjin Gazulli astronom dhe diplomat i shekullit XV" Rilindja, 1964, f. 12.
26. "Fjalori Enciklopedik shqiptar Vell. I" Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008.
27. S. Juric S. Prilozki biografiji Ivana Gazulica. Anali Historijskog institute Dubrovnik. God. VIII-X (1962) 447-479; Tadij, J. Johannes Gazulus duvrovacki humanista 1442-1444 veka ZFK knj. VIII, Sponenica Mihaila Dinica 2, Beograd 1964, 385-424.
28. "Historia e letërsisë shqipe I-II", Prishtinë 1968, f. 169.
29. Galanti A., L'Albania, Roma 1961, f 8; Gjini, Gasper, "Ishëskevia e Shkup Prizrenit" ndër shekuj. Forizaj, "Drita", 1992, f. 185.
30. Prenushi, Mikel. "Kontributi shqiptarë në Rilindjen Evropiane" Shtëpia botuese 8 Nëntori 1981, F 37.
31. "Bota Shqiptare" libër leximi për kursin e natës të shkollës së mesme, botim i Ministrisë së Arsimit, Tiranë, 1943- XXI f. 521.

A

ARGUMENT

NGA DR. SILVANA LEKA

Rast krejt të veçantë në krijimtari letrare lidhur me kulturën detare dhe detin si kulturë përfaqësuese vepra e Martin Camaj. Që krijimtaria e këtij autori "i ka rrënjët në kulturën shqiptare, sidomos në mitin e trashëguar", në etnosin apo onomastikën e Temalit si vendlindje, mund ta vërejmë e ta gjejmë të dëshmuar në të gjithë veprën e tij të gjerë. Larg çdo dyshimi krijimtaria e Camajit në frymë ka përkatësi malore si *topos* dhe *maiores* si *logos*.

Peizazhi i Dukagjinit ka ndikuar te "ky pinjuell malesh", siç e cilëson Koliqi, aq sa një peizazh mund të ndikojë në formimin e botës së një shkrimtari të lindur, i cili kur kujton viset e veta shprehet: *Kam lindë në një vis të egër ku s'ka shkel kurrë kamba e kalit, kaq i thyeshëm është ky vend.*²

Por, përkatësimin e Camajit për nga mali mund ta ndjehmë instinktivisht qoftë edhe duke iu drejtuar thjesht titujve referencialë në veprën e tij të gjerë, nisur që nga krijimtaria e tij e hershme apo edhe qoftë në tematika të shprehura. Vëllimet e tij të parë "Një fyell ndër male" (1953), "Kanga e vërrinit" (1954) sikur parathënë dhe skajojnë krijimtarinë e tij. Por kjo është veç dukja e thjeshtë.

Vëllimi me proza "Shkundullima", përbën një pikë kthese, duke e shkrëputur Camajin nga motivet vetëm tokësore dhe e hapur këtë autor drejt motiveve detare, prej nga Camaj nuk u nda, si në poezi ashtu edhe në prozën e tij, që paraqet një rast krejt të veçantë.

Prozat e vëllimit "Shkundullima" paraqesin toposë të ndryshme e të larmishëm. Toposi i parë prirret nga viset malore, në veri të Shqipërisë, drejt jetës në bjeshkë, kryesisht. Por në disa proza të këtij vëllimi, të tilla si "Shkundullima", "Katundi me gjuhë të fshetë" dhe "Gjon Gazulli" atmosfera është detare. Ndonëse deti nuk është i Shqipërisë, ata që veprojnë në këto proza janë arbëreshë, pra botë shqiptare.

Edhe bota mitike dhe mitologjike e "fisit" të tij, në mjaft poezi të Camajit prirret për nga deti. Si të tilla do të përmendim vargjet "Unë jam në detin e tingujve" (Mbramja ashtë larg); "Petkat e saj teren buzë detit"; (Gjarpri e Grueja); "Retë me rrarë thella në det" (Retë e Oqeanit); "Me ngrehë një këshqjellë në det me hala peshku" (Grueja me mëngji); "në fundin e katunit mbi det..."

apo
Dheu im është i përmendun për humneret e thella ndër banorët e malit e të fushës deri në det.

(Dita e malit tem)

apo
Niset për gurbet punëtori Me një copë qielli në krah e krypë deti në kutia pishe.

Asimetria me prejardhje nga metamorfozat zoomorfike të motiveve detare është shndërrimi i gruas në breshkën ktonike, një krijesë tripërmasore për nga simbolikat. Këtë modelim metamorfozash e ndeshim edhe te shndërrimet e "së Bukurës së Detit" apo "Hyrisë së detit" të përrallave shqiptare...

Rasti "Martin Camaj", romani "Dranja" përballë detit

Në kujtim të 25-vjetorit të ndarjes nga jeta



Martin Camaj

(Fragment)
apo
Në breg të detit djali kafshon në curr
E deti me vala lëpin bregun në gjumë.
(Idilë vere)

Por vepra tipike, të cilën kam marrë më gjerësisht në shqyrtim është proza e tij "Dranja", krejt atipike si krijimtaria dhe përfaqësuese e kuotave të larta për nga vlerat. Nga pikëpamja formale e një proze kjo veperë shmanget simetritë e pritshme. Së pari sepse ajo cilësohet madrigal - një formë muzikore vokale kjo e zgjedhur jo rastësisht nga autori, por si entitet polifonik i përshtatur për atë formë narrative që Camaj ka zgjedhur për ta pasuruar veprën e tij në prozë, duke mbetur sekular dhe e shenjtë njëherazi. E tillë tingëllon edhe vepra - e këndueshme, jo thjesht e lexueshme, por plot regjistra komunikimi dhe me shumëllajshmëri zhanresh në të.

Në një studim mbi veprën Arshi Pipa e cilëson atë si një hibridizim të zhanrit letrar (prozë që i përafrohet poezisë së shkruar si prozë) si dhe të vetë personazhit Dranja si *persona poetica* (gruaja e shndërruar në breshkë).

Paraqitja e botës totemike shqiptare, e botës ktonike, me gjarpurin dhe breshkën, është përcaktimi i arealit-truall ku këto toteme e ruajnë ende fuqinë vepruese - veriu malor të Shqipërisë.

Ndërkaq toposi real që autori krijon për Dranjen nuk është as mali as deti, por diçka midis, diçka që të lejon personazhin - breshkë të shkojë drejt detit, ku "lindja



fusharake dhe detare. Dranja e secilit prej këtyre toposve është një personazh tjetër, më vete për nga narrativa dhe funksionet.

Në studimin e tij, veç elementit mbidetar, të ndërmjetëm dhe malor, Arshi Pipa nënvijëzon edhe peizazhin detar dhe bregdetar si përjetim natyror, social dhe kulturor të ndryshëm për Dranjen. Rreth këtij teksti Arshi Pipa shkruan: "Në paragrafin tjetër historia e Shqipërisë bregdetare të pushtuar nga fuqi të ndryshme mesdhetare degradon në një "lojë" spektakolare me malësorët të vendosur "malt në bria" që vështrojnë me Schadenfreude [keqdashje, zemërligësi]."

Pjesa tjetër e paragrafit i kundërvihet qetësisht qytetërimi perëndimor nëpërmjet folklorit autokton. Qytetërimi i huaj kërcënonte të shkombëtarizonte malësorët gegë. Për të parandaluar përzjerjen, ata adoptuan një mënyrë pak të ashpër jetese ("përgjysmë i latuem"), të papajteshme me zakonet gjithnjë e më të rafinuara të sunduesve të tyre, ndërkohë që zhvillonin një gjuhë

të paafërueshme, tingull-rëndë, për të shkurajuar studiuesit që donin ta regjistronin atë mbi "rrasa e pergama". Madrigali mbaron me një paragraf mbi kultin e diellit të malësorëve shqiptarë, si besimi i tyre i vërtetë pagan".⁴

Rëndësi të veçantë në këndvështrimin tim përmban materiali i pjesës së dytë të veprës, ku shpjellohen ndodhitë e Dranjes përballë një realiteti krejt të ri dhe të panjohur. Është zhvendosja e "breshkës" në "dhëna me ligje e doke tjera". Aty përjetohet edhe përvoja e mrekullueshme e takimit për herë të parë me detin.

Është simbolikë domethënëse që në këtë rrugëtim drejt së panjohurës, Dranjes i prin lumi Drin, që natyrshëm shkon të derdhet në det, pikërisht në Kepin e Rodonit, një zonë shumë e ndjeshme gjeoemcionale për kujtesën detare të shqiptarëve. Ky topos është i lidhur me mitologjinë antike, perëndinë Redon, ashtu edhe me motet e lavdishme të Skënderbeut, që zotëronte aty një skelë dhe një këshqjellë mbrojtëse në det.

Pikërisht aty Dranja ndjen për herë të parë puhnë dhe aromat e kripura detare. Episodet paraprirëse janë veshur me simbole kundër *totalitarizmit zi* (ndoshta nën matricën e rrezikut, armikut, pushtimit që vjen nga deti, me breshkë e stërmadhe që del nga ujrut është hamendësuar pushtimi fashist), sikundërse edhe të *totalitarizmit të kuq*, simbolizuar nga bretkosa sykuqe.

Duke lënë pas analizën e pjesës tjetër të veprës, që nuk i rikthehet më motiveve detare, theksojmë se "Dranja" përbën një veçanti të jo fort të ndeshur në letërsinë shqiptare për sa i përket metamorfozës së zhanrit, e ngjashme me metamorfozën e vetë per-



Martin Camaj, "Vatra" SHBA

sonazhit, ashtu edhe në kompleksitetin e lëndës letrare që kjo vepër paraqet.

Përveç këtyre, për të dëshmuar vëmendjen dhe ndjesinë e autorit ndaj lëndës detare do të mjaftonin sikur edhe këto tri poezi:

Deti anmik

Deti bar gjithçka, thanë të vjetrit,

Me erë prorrë m'njish krah
Dhe pisha e pemë frytore në një anë

I lakoi përdhe.
Na, banorët e lashtë,
Domi mirë tokën. Edhe gjinkal-

lave
Të plasuna vape te rrajët e pishave

U vjen era rrëshinë e jo det.
Edhe fryma e zotave
U fsheh në gurë e jo në detin
E njelmë! Fliqtë e ambël,
Buzë-përgjakun u bien mbi kre-

na

Flijimi.

Retë e oqeanit

Eci krahas me to
Nëpër ditën e gjatë.

Aty ku vetë
Asht skaji i kohës së matun
Me rrahje zemre milionësh
Në kërkim të një emni.
Retë me rrajë t' thella në det
Rriten e bahen lisa:
Ndër grykat e tyne fantazma
Konkisdadorësh
Vjelin pemë.

Leni lumejt

Leni lumejt të derdhen të gjithë në Adrië

dhe në detin Jon
e rrezja të lodrojtë më valë
për kënaqje të zemrës e të mendës sonë.

Vashat t'i lagun kambët n'ujë
para syve tonë të qartë.

Ngjyra e grunit dhe e ullinit
t'u shihet në faqe e në bebëzat e synit
dhe kulmi i shpisë të jetë bunge
e pragu guri.

Kur të ulen valët
fryma jonë do të matet
me gjansinë e detit: atëherë
do të pushojmë
te kambët e bjeshkve të bardha.

Autorët shqiptarë, mes të cilëve edhe Martin Camaj, i janë qasur detit dhe kulturës së prejardhur prej tij jo thjesht dhe vetëm si objekt estetik, por edhe si argument ndihmës në mbështetje të argumentit që e bën më të pranishme dhe më të qenësishme vëmendjen e krijesve shqiptarë ndaj detit. Prej këtej buron pasurimi i botës shpirtërore me kulturën detare dhe me vetë detin, si një prej simboleve më të rëndësishëm jo vetëm të literaturës, por edhe të qytetërimit njerëzor, që e vendos kulturën shqiptare përkrah asaj të fqinjëve të vet.

Shënime

* M. Camaj, *Vepra letrare 1*, Shtëpia botuese "Apollonia", Tiranë, 1986, f. 139.

* B. Demiraj, *Jeta akademike e Martin Camaj*, në Konferencën Shkencore Martin Camaj për kulturën shqiptare. *Shkrimtar i dhe albanologu*, "Studime shqiptare", Nr. 17, Shkollë 2011, f. 244.

* Shih Shaban Sinani, *Camaj i paskajuar*, "Qendra e Studimeve Albanologjike", Tiranë 2011 dhe Shaban Sinani, *Kodi i ri për shenjë e vjetër në romanin "Dranja" të Martin Camajit*, "Studime filologjike", Nr. 3-4, Tiranë, 2008, f. 67-69.

* Shih Arshi Pipa, *Poezia dhe poetika e Camajit*, Materiali u përkthye për "Milosao" nga Ergys Petriti. Marrë nga ALBANICA (A quarterly Journal of Albanological Research and Criticism) SPECIAL ISSUE, DEDICATED TO MARTIN CAMAJ, Numri 2, pranverë 1991. Botuar nga Arshi Pipa. Botuar në "Milosao", "Gazeta shqiptare", Tiranë 1.7.2012.

L

LETËRSIA

NGA BEN ANDONI

Gjërërat më cinike, që kanë lidhje me regjimin e shkuar, janë ato që lidhen me përfshirjen e artit në këtë politikë dhe ndihmën e pakursyer të saj. Një e tillë ka qenë vepra në gjini të ndryshme që u bë kushtuar tharjes së Kënetës së Maliqit dhe të gjithë pasojat e kohës. "Kufoma lëvizëse" do u referohet Sami Repishti kolegëve të ngratë, që asokohe punuan në atë vend dhe ku një pjesë e madhe e përbënin të dënuarit. Mes tyre edhe Dhimitër Pasko dhe Arshi Pipa.

Për shumë vite, romani "Kënetë" i Fatmir Gjatës evokoi një realitet që nuk shkonte asesi me të vërtetën e Maliqit dhe dënimin e ashpër të inxhinierëve të damkosur në libër. Ashtu si në këtë roman, një pjesë e madhe e letërsisë së asaj kohe, prodhoi një shumësi veprash në disiplina të ndryshme, që e justifikon vendimin e ashpër për pushkatimin e inxhinierëve dhe persekutimet e tjera të Maliqit. E dhimbshmja që ndodhi në Kampin e Vloçishtit përgjatë viteve 1946-1950 nuk u tregua kurrë si duhet.

Në një përpjekje institucionale të mëparshme, Instituti i Krimeve të Komunitetit dhe së fundmi Autoriteti i Hapjes së Dosjeve janë duke punuar për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarje të dhimbshme.

Që pas botimit të romanit "Kënetë", ku ngrihet deri në apoteozë forca popullore kundër sabotatorëve dhe të huajve, ky libër ka qenë pjesë e detyrueshme e kurrikulës shkollore dhe që nga faqet e tij, breza të tërë shqiptarësh, kanë marrë referimet e para për "armikun" Harri Fultz dhe nxënësit e tij që do ekzekutoheshin me radhë. Ndërkohë propaganda përkrahur vullnetarë, që punojnë me sakrificë, por që janë të vetëdijshëm dhe të kënaqur se po ia dalin vetëm falë ndihmës së partisë.

Falë propagandës dhe kalimit të viteve, impakti i librit "Kënetë" ka qenë aq i madh sa që pothuaj e ka veshur të vërtetën e kampit dhe ndodhive atje. Por nuk mund ta zhbënte kurrë të vërtetën, që ruhej prej njerëzve. Krejt ndryshe e përkrahur ndodhinë e "Kënetës" në romanin e tij Makensian Bungo. Autori, që e kishte parë vetë atë realitet, rrëfen vështirësitë në këtë kamp dhe punën e stërmundimshme.

Përkrahur njerëzit e letrave që janë çuar për edukim atje dhe vështirësitë e mbijetesës së tyre. Trajtesa është e ngjashme me ato që fliten në ish-kampet naziste, uria, lufta për mbijetesë, zvetëni mi human, i cili qëndron si sfinks kudo. Qindra të dënuar politikë mbijetojnë në ekstrem dhe duket se thjesht me qenësinë atje kanë marrë dënimin me vdekje. Ky

Letërsia dhe arti i pasluftës të gjithë këtë kalvar, që pësuan njerëzit e procesit të "Kënetës së Maliqit", e ndihmoi në favor të propagandës së kohës, duke i dhënë një dënim të dytë edhe më të ashpër me anë të krijimtarisë letrare. Një dënim, që sot nuk ka çmim, sepse mori jetë njerëzish, teksa paradoksalisht arti i dënoi edhe njëherë tjetër viktimat e vdekura... me turp. Ndaj tragjedia e tyre duhet filluar duke e zhbërë që nga arti.

“Kënetë e Maliqit”, zhbërja e tragjedisë duhet filluar nga arti



është një realitet krejt ndryshe nga ai i përcjellë. Një ish-dëshmitar tjetër Arshi Pipa në një poemë të tij e përkrahur në formë poetike të "Kanali" i tij këtë dhimbje të madhe. Dhe dëshmi të tëra, falë Institutit të Krimeve të Komunitetit iu kushtuan dhe dolën në 27 vitet e fundit edhe nga ana e Beqir Ajazit, At Zef Pllumit, Ejell Çobës, Sulejman Xhixhës e pak të tjerëve. Repishti gjen metaforat më të përshatshme për njerëzit e kënetës: "kufoma lëvizëse" ose "leckamanë

të mbuluar me baltë", që mos mjaftonte puna e rëndë, por duhet të mbaheshin të gjithë kohën të lidhur me zinxhirë.

Megjithatë publiku i gjerë për dekada të tëra u mbajt me propagandën e filmit, romanin "Kënetë" dhe dokumentarëve kushtuar kësaj kohe, që e bëri tragjedinë të ngjante si një shfaqje të domosdoshme të kohës kundër armikut të klasës.

Sot, për hulumtimin e kësaj ngjarje ka të kushtuar faqe të tëra, por duket se institucionalizimi i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, do të hedhë dritë profesionale për paradokset e asaj kohe. Autoriteti, prej muajsh, në mënyrë shumë sistematike e profesionale po sjell materialet arkivore që gjenden për gjyqet e kohës. Ndërkohë, këtë javë, ajo ka sjellë ngjarjet e Maliqit përmes një CD-je me materialet e digitalizuara dhe ka plotësuar për publikun një dosje të plotë me lëndë arkivore, foto, studime për ngjarjen dhe madje edhe pjesë filmike për të.

Romani "Kënetë"

Që pas botimit të romanit "Kënetë", ku ngrihet deri në apoteozë forca popullore kundër sabotatorëve dhe të huajve, ky libër ka qenë pjesë e detyrueshme e kurrikulës shkollore dhe që nga faqet e tij, breza të tërë shqiptarësh, kanë marrë referimet e para për "armikun" Harri Fultz dhe nxënësit e tij që do ekzekutoheshin me radhë. Ndërkohë propaganda përkrahur vullnetarë, që punojnë me sakrificë, por që janë të vetëdijshëm dhe të kënaqur se po ia dalin vetëm falë ndihmës së partisë.

Ditët e fundit ngjarjes iu kushtua prej Autoritetit edhe një aktivitet, që tregoi staturat e vërteta të njerëzve të Maliqit. E ashtu quajtura "organizatë tekniko-sabotatore" kishte në përbërje të saj Abdyl Sharra, 35 vjeç, kryeinxhinier në ndërmarrjen për tharjen e kënetës së Maliqit, njeriu që mori akuzën kryesore si "iniciatori kryesor i sabotimeve në stil të gjerë për ndërmarrjet e mëdha që bënte pushteti popullor"; Kujtim Beqirin, 30 vjeç, pinjoll i një familje patriotike, medalje e artë në inxhinieri civile në Universitetin e Vjenës, drejtor në punimet e Maliqit; Vasil Manon, inxhinier në kënetë, që i akuzuar bashkë me të shoqen Zyrikën (e cila u pushkatua shtatzënë), për lidhjet e tyre dhe kontakte të herëpashërshme me agjentët e UNRRA-s, por edhe të denigruar në letërsi dhe në dokumentet që do silleshin më vonë; Pandeli Zografini dhe Mario Guarnierin, geometra në kënetën e Maliqit; Eugenio Scaturro, italian, llogaritar në Maliq; Mihal Stratoberdhën, Anastas Riston dhe Jani Vasilin.

Fati i tyre do ishte nga lajmet kryesore, kur filli gjyqi më 8 nëntor 1946 dhe përfunduan pas 10 ditësh. "Grupi i sabotatorëve të kënetës së Maliqit" ndiqej direkt nga procesi, që transmetohej publikisht me altoparlant, e që u zhvillua në kinema "Nacional", me skenar të parapërgatitur në detajet më të vogla. Grupi i dënuar me vdekje u ekzekutua në Maliq, më 19 nëntor 1946 dhe pas kësaj u dha dërrma rreth 80 ish-nxënëse të shkollës teknike të Harry Fulzit duke bërë shpëtimin e gjatë të marrëdhënieve me SHBA-në e Britaninë e Madhe, për t'u bërë pjesë e familjes së Lindjes Komuniste. Në të ardhmen, Autoriteti, mund të shërbejë dhe si një vend ku mund të frymëzohen artistët që duan të flasin për artin.

Letërsia dhe arti i viteve të para të pasluftës të gjithë këtë kalvar, që pësuan njerëzit e Kënetës së Maliqit, e ndihmoi në favor të propagandës së kohës, duke i dhënë një dënim të dytë edhe më të ashpër me anë të krijimtarisë letrare. Një dënim, që sot nuk ka çmim, sepse mori jetë njerëzish, teksa paradoksalisht arti i dënoi edhe njëherë tjetër viktimat e vdekura me... turp. Ndaj tragjedia e tyre duhet filluar duke e zhbërë që nga arti.

A

ARGUMENT

NGA SHPËTIM ÇUÇKA

Vija

Studiuesit, historianët, publicistët dhe shkrimtarët e sotëm kanë të drejtën e tyre ta quajnë diçka të vjetëruar politizimin e D. Agollit. Ata kanë të drejtën e tyre të dalin para shoqërisë si të papolitizuar, jashtë çdo politike e mbi çdo shtresë shoqërore. Tjetër punë pastaj, nëse njerëzit e besojnë këtë pozë apo jo. Këtu vjen në kujtesë një shprehje shumë e njohur dhe shumë e thjeshtë: "Jeta jashtë politikës është gënjeshtëri dhe hipokrizi".

Mirëpo edhe D. Agolli kishte të drejtën e tij, ashtu si pjesa më e mirë e krijesve tanë të të gjitha kohërave, të mbante qëndrim të hapur politik: në të mirë të popullit. Dhe ja përse:

Fëmijë,
ku ta dinim ne
aherë
Se vendi
do na thosh:
tani në dorë
Do merrni
banka,
trena,
buldozerë,
Fabrika,
ara,
varka dhe vaporë...
Fëmijë,
ku ta dinim
se një ditë
Do piketonim
Fierzë

e Va Dejë,
T'i lidhnim
tela
Mokrës dhe Mirditës
Dhe maleve
t'u thoshim:
Eh, me lejë?
Me lejë,
male?
Lërnani
t'ju çajmë!

Një jete të tillë, jetës së punës ndërtimtare, mund t'i ngrihen këngë. Madje jo vetëm mund, por duhet t'i ngrihen këngë. Pikërisht këta ka bërë D. Agolli. Ai i ka kënduar punës së një populli të tërë! Dhe burim i frymëzimit të tij ka qenë shpirti popullor:

Do thoni ju:
po plakësh
në mendime,
Po bëhesh
dalngadalë
konservator.
Se vargjet
kanë ritëm,
kanë rimë,
Se vargjet
kanë shpirtin
popullor...
Ky shpirt
të lulëzojë
varg pas vargu,
Pa vërmëni
llagape
sa të doni!
Atë si simfoni



e ndiej
së largu,
E ndiej si bubullimë dhe jehonë.

Dhe, sikur ta kishte parandier reagimin e ndonjë lexuesi mosbesues dhe të ftohtë ndaj problemeve të vërteta të jetës shoqërore, D. Agolli vazhdon:

Më falni
që u bëra i mërztishëm
Dhe vargjet
po i mbush
me frymë
agjitacioni
të përditshëm,
Pa abstraksion,
po drejt
e në praktikë!
Po ndonjëherë
duhet dhe praktika,
Që thellë
të kuptohet
poetika...

E tillë ishte poezia e D. Agollit afro pesëdhjetë vjet më parë. Gjithkush ka të drejtën të pyesë: Po sot, ç'tema prekin poetët e shkrimtarët? Sa të lidhura me realitetin, me praktikën, janë krijimet e tyre? Dhe cili është ky realitet, kjo praktikë?

Të krijohet përshtypja se sot këto pyetje nuk shtrohen pothuajse fare dhe se për realitetin, për jetën praktike në shoqërinë tonë, mund të ketë aq pikëpamje, sa njerëz janë. Gjithnjë në rast se këta njerëz e vrasin mendjen për të tilla çështje dhe nëse ata – për shkak të halleve a jetës parazitare që bëjnë – nuk e kanë kyçur përfundimisht kutizën e mendimit duke e hedhur hapësinë në ndonjë humbëritë.

Pyetjet e mësipërme nuk shtrohen edhe për një arsye tjetër, më "estetike": arti, letërsia, nuk shihen si veprimtari shoqërore, pra, veprimtari me përgjegjësi shoqërore, me përgjegjësi përpara shoqërisë. Arti e letërsia tani shihen si çështje vetjake e artistit dhe letrarit, i cili para së gjithash dhe kryesisht e sheh krijimtarinë e tij si krijimtari financiare duke mbajtur parasysh shije dhe blerës të huaj.

Përkundrazi, njerëzit, të cilëve poeti u kushton poemën e tij, janë të veçantë dhe koha që i lindi ishte gjithashtu e veçantë. Ishte një realitet i heshtur e pa bujë, si jeta e njerëzve të thjeshtë, si vetë këta njerëz të thjeshtë e të pjekur nga jeta:

Kalon një kohë
e duke u menduar
Për çka këndova
e shkrova
vjet me radhë,
Më diini ju
përpara
të ngarkuar
Me shqetësime,
munde,
luftë,
halle.
Mes dhembjeve
të forta,
të gjakosura,
Ju lindi
komunizmi
nëpër zjarre,
Që dhembjet
në karvanë
të pasosura
T'ia fshinin
gjithë botës
shqiptare.
Dhe dhembje
s'kishte pak
kjo botë

e maleve;
Një gur të rrokullisje,
do dëgjoje
Rënkimin
kombëtar
si ankh të valëve
Në breg të detit
para se të agojë.
Por ju
përvëshët krahët
dhe si buaj
lu futët
Shqipërisë
lënë djerrë
Dhe në djerrinë
mbollët
jetën tuaj
Që s'ishte mbjellë
kurrë ndonjëherë...

Sikur njerëzit e sotëm të shihnin në ndonjë galeri arti të tilla tablo, vallë ç'do të mendonin: që ato janë realiste apo sajesa piktorësh të çartur? Poema e Dritëro Agollit, e gjithë poezia dhe pjesa më e mirë e prozës, janë dëshmi e vërtetësisë së këtyre tablove. Ndaj edhe të tilla vargje, jo vetëm për rrjedhshmërinë dhe harmoninë e tyre, kumbojnë e ngjallin përjetim të thella në njerëzit me përvojë të shëndoshë jete, në njerëzit që e kanë lexuar librin e hidhur të jetës dhe nuk janë rritur me ëndrra pa themele.

Vijon poema:
Dhe malet hijerëndë
frymë morën

Dhe mijra lule
ish-djerrina
hapi.
Urryet fodullëkun,
pabesitë
Dhe rrnëjt
ua kërkua,
ua shkulet
Dhe te ky vend
i kaltër
dhe me dritë
Me maskarenj
në sofër
nuk u ulët.

Në shoqërinë tonë sot nuk përcmohet fodullëku, përkundrazi. Nuk u çirret maska pabesive, përkundrazi. Dhe shoqërimi me maskarenjtë është shenjë pozitive dhe kryelartësie shoqërore. Shkruan më tej poeti:

Premtimin ne ia dhamë
historisë
T'ia fshijmë
vojçet
popullit nga
dölëm,
T'i vëmë krahë
gjithë Shqipërisë,
Ndaj muskujt
edhe mendjen tonë
mbollëm.

Të gjithë ata – të shumtë a të paktë, kjo nuk ka rëndësi – që sot i shohin me mospërfillje e mosbesim të tilla vargje dhe që çuditën nga një mendësi e tillë, e cila përfytyron se si njeriu i vë vetes detyra përpara historisë dhe shoqërisë dhe se si ai lufton për të zhdukur vuajtjet e popullit, e gjithë kjo kategori njerëzish natyrisht as që do t'ia dijë për një letërsi të tillë, domethënë për letërsinë e vërtetë.

Dhe jo më kot punët tona shkojnë kështu si shkojnë: me shifrat e larta të papunësisë dhe të kriminalitetit, me rënien morale dhe mendore të masës së madhe të popullsisë, me degradimin e mjedisit dhe të natyrës. Me shumë plagë të tjera shoqërore, që ngjallin dëshpërim të thellë dhe që i kanë dhënë shkas shprehjes së zymtë: "Ky vend s'bëhet".

Mesazhet e D. Agollit, mesazhet e poemës "Komunistët", tingëllojnë (për ata të paktë që mund t'i lexojnë) si diçka vegimtare, si gurmë të një epoke aq të largët, sa në të vërtetë duket sikur nuk ka ekzistuar kurrë. Kundërshtarët e së mirës së popullit ia kanë arritur qëllimit: të bëjnë të harrohet madhështia e jetës ndërtimtare dhe e këngës kushtuar kësaj jete, e jetës dhe këngës së punës. Dhe kanë ngjallur iluzionin e jetës së qejfit dhe këngën e qejfit (Si shkruhet mureve të kryeqytetit? Jeta osh qef!).

Ndërkaq një popull i tërë mbe-tet:

anës dritës i paparë,
.....
pranë dritës i panxënë...

me mendje si sufist, përhapur mbi shkretëtirë, skllav i pasionit, beduin i shpirtit mendoj për atë çka në jete është më mirë.

Sofist cinik, bohem pa cak, peng i dëshirave rastësore, kështu endet ky shpirt i lirë, in perpetuum prora.

Dimër

Ra ky mot e nuk u pamë mbështjellë mistershëm në këll'acar na ndan ndër pole të skajshëm ky i ftohtë idhnak, i marrë.

Kujtimi i një çasti që ska ndodhur, shpresa e marrë për deja vù, çdo gjë e veshur me lësin e bardhë, sinjal që më drejton kah ty.

Pragverë

Vesë diamantesh, n'prag t'agut shtrirë si tapet, ende mbështjellë në freskinë joshëse para t'mxhitit afrikan që në derën e shpirtit nis e troket.

Ndezja e ngjyrave nën përthyerjen e dritës t'aurorës milite sjell Pashken e jetës si një flutur magjike.

Njeriu dhe turma

Në metrole e bjerra, Tërhiqen turma zvarrë, Kapen pas hekurash të ndryshkur,

nga koha, si njerëz që përqafohen Kur ndiejnë mall.

Humbet njeriu, Në vrapin e kohës, E kaplon vetmia, Mërzia e post-modernitetit..

Rishpik velen në turmën gri, Bërtet nevoja për ekzistencë Nuk gjen as paqe, as qelësi, Në perpjekje për të gjelur veten e vet.

Detari

Fanari që sheh detari n'mes të blusë së paanë, ndrin si aurora n'ag, zemrën që në vetmi qan.

Zbulon misteret e detrave të thellë, marinari khaketë-zbërthyer, tek mërmërin këngë të vjetra, si pirat mendje-trëmbyer.

Modernity and humanism

Finding light amongst life's miseries, continue hopping when all fallers, standing by your ideals even when they betray false convictions, that's modern challenges in a nutshell.

To witness peace on the face of war, To be hopeful when all hope files, To expect the unexpected when all fallers, To be human after all.

Opinion *i* Ditës

Nderim për vizionin e Shtrausit dhe një stacion që ne e humbëm

Nga Ilir Meta

(vijon nga faqja 1)

... modeste në kujtim të 30-vjeçtorit të vizitës së parë në Shqipërinë komuniste të kryeministrit bavarez, Franz Josef Straus.

Sot jam edhe më shumë i gëzuar që në cilësinë e Presidentit të Republikës t'i jap në emër të qytetarëve shqiptarë një vlerësim të posaçëm, këtij personaliteti të madh e të shquar politik jo vetëm për gjermanët, por edhe për shqiptarët.

Franz Josef Straus zë një vend të veçantë në memorien tonë kolektive si i vetmi politikan perëndimor, që vizitoi Shqipërinë e izoluar komuniste para rënies së perdes së hekurt.

Kjo vizitë ngjalli shumë shprehje në rrethin e atyre që kuptonin atipizmin e saj për rrethanat e kohës. Dhe sot, ende flasim për ndryshimet epokale që do të kishte sjellë, nëse do të ishte kuptuar si duhej mesazhi që ai përcolli në Tiranën zrtare.

Sot ne e dimë, se guximi dhe vizioni i Shtrausit për të vizituar Tiranën shoqërohej me një oportunitet të jashtëzakonshëm, që do të kishte transformuar krejt historinë dhe marrëdhënien tonë me Europën dhe botën.

Sot ne e dimë se autori i librit "Projekti i Madh" evropian kish të vizionin largpamës për ta parë



kufirin e Europës të shtrirë edhe në Lindje të saj. Pavarësisht këtij stacioni të humbur prej nesh, vizita e Shtraus në Tiranë padyshim që përbën gurthemelin e 30-vjeçtorit të marrëdhënieve diplomatike të rivendosura ndërmjet Shqipërisë dhe Gjermanisë.

Ndaj, kjo ceremoni në 105-vjeçtorin e Pavarësisë së Shqipërisë

është shprehje e vullnetit më të sinqertë jo vetëm për të vlerësuar një mik të shqiptarëve, por edhe për të rikonfirmuar perspektivën e shkëlqyer të marrëdhënieve që kanë vendosur dy vendet tona.

Gjermania është konsoliduar tashmë si partner kyç e strategjik për Shqipërinë, por edhe për sigurinë, paqen dhe begatinë për të gjithë Ballkanin Perëndimor.

Gjermania është sot shtëpia e shumë shqiptarëve, të cilët janë integruar më së miri dhe e përfaqësojnë denjësisht imazhin e vendit të tyre.

Ne jemi mirënjohës për mbështetjen që Gjermania ka dhënë e na jep, për integrimin evropian, për të gjithë atë ndihmë të jashtëzakonshme në ekonomi, infrastrukturë, energji dhe në të gjithë

sektorët e tjerë jetikë për një zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik dhe për një arsimim profesional, veçanërisht për rininë tonë.

Presidenti Steinmeier më siguroi gjatë vizitës që zhvillova në Berlin se marrëdhëniet me Shqipërinë do të vazhdojnë të jenë të një rëndësie të veçantë për Gjermaninë, si marrëdhënie tepër të rëndësishme për të gjithë stabilitetin dhe perspektivën evropiane të rajonit tonë.

Ne jemi me fat që kemi rreth vetes miq të mirë e të çmuar dhe simbol i kësaj miqësie gjermano-shqiptare është edhe familja Shtraus. Jam veçanërisht i prekur, që vajza e mikut Shtraus, Monika, që na nderon sot me prezencën e saj, është anëtare e Grupit të Miqve të Shqipërisë në Parlamentin Evropian.

Jam i sigurt në përpjekjen e sinqertë të saj për të hapur negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, duke iu afruar gjithnjë e më shumë vizionit të babait të saj, për ta parë edhe rajonin tonë brenda familjes evropiane.

Duke ju falënderuar edhe një herë për prezencën, dëshiroj ta mbyll me urimin që e kishte për zemër Josef Straus: "Për një miqësi më të gjatë, edhe për shumë vite!".

Pagëzuesit të kësaj miqësie kam kënaqësinë dhe nderin t'i akordoj sot dekoratën më të lartë të "Flamurit Kombëtar".

* Fjala me rastin e dekorimit të ish-kryeministrit bavarez, Franc Jozef Shtraus, medalje që iu dorëzua vajzës së tij.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



Opinion i Ditës

Dhuna ndaj grave në Shqipëri fshihet pas privatësisë familjare

“ZËRI I AMERIKËS”

(vijon nga faqja 1)

... e për të frenuar këtë dukuri mbizotëruese.

Aktivizmi dyjavor kundër dhunës me bazë gjinore nisi ndërkohë që një tjetër nënë humbi jetën në një fshat të Kavajës, e goditur me thika nga bashkëshorti.

Gjykata e Krimeve të Rënda vendosi të lërë në burg Sami Metushin për vrasjen e bashkëshortes së tij, Sose Metushi, në fshatin Karpen të Kavajës. Ai i mori jetën pas disa goditjeve me thika nënës së 5 fëmijëve të çifitit, për grindje të rëndomta shtëpiake, duke tronditur rëndë opinionin publik me këtë ngjarje tragjike. “Gjendja është vërtet e rëndë dhe masat e deritanishme janë të pamjaftueshme, si nga gjykata, policia dhe organizatat e të drejtave njerëzore. Një tjetër zonjë humbi jetën në Kavajë dy ditë më parë dhe një mori rastesh dhune regjistruar në të gjithë vendin”, – tha Fabiola Egro nga rrjeti i Qendrave Komunitare “Sot për të ardhmen”.

Bujku nga Kavaja goditi bashkëshorten me thika, ndërsa fëmijët e shtangur në oborr mbetën jetimë për një minutë dhune tragjike të babait ndaj nënës së tyre, e cila mbante familjen dhe kujdeset për të ta. Pendesa dhe tronditja e rëndë psikologjike nuk kthen më në jetë bashkëshorten dhe as shton kujdesin për 5 fëmijët e mbetur tani pa asnjë mbrojtje, edhe me probleme të ngjashme sociale.

“Vrasjet janë pjesa më tragjike e një dhune të fshehur gjithandaj në familjet shqiptare. Ato nisin zakonisht me gjeşte të vogla dhune e diskriminimi dhe përfun-



dojnë shumë keq. Edukimi dhe ndërgjegjësimi duhet të nisë në moshën sa më të vogël”, – tha Ines Xhelilaj, nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas.

Dhuna në familjet shqiptare është e përhapur në fshat dhe në qytet, në të gjitha shtresat dhe profesionet. Pak kohë më parë një gjyqtare humbi jetën nga plumbat e revolverit të ish-bashkëshortit, pasi doli nga burgimi i shkurtër po për dhunë.


Ai e priti gjyqtaren pranë parkimit të makinës dhe shtiu kundër saj pas një historie të gjatë dhune mes tyre, një vrasje e pritshme dhe e paralajmëruar nga vetë

gjyqtarja e ndjerë.

“Pjesa më e vështirë e dhunës në familje është se ajo fshihet pas privatësisë së familjes. Nuk është e lehtë të përfshihesh në këto konflikte, që mbyllen pas derës së banesës. Sa më shumë të flitet për to dhe sa më shumë të hapet familja për to, aq më mirë do të jetë”, – tha Erjona Mulellari nga Aleanca Gjimore për Zhvillim. Organizatat e grave nisën sot seri veprimtarish dyjavore ndërgjegjëse në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës kundër Grave, që po rrëmben jetë grash e vajzash shqiptare çdo muaj.

Veprimtaritë po zhvillohen në

kryeqytet dhe në periferi problematike si kënetat e Durrësit dhe zona të tilla të largëta, ku dhuna ndaj grave vazhdon të mbahet e fshehur. Shqipëria po zhvillon dy javë ndërgjegjësimi për të ndaluar dhunën ndaj grave, për më shumë punë, demokraci dhe të drejta njerëzore në shoqëri. Dhuna në familje ka mbërthyer shoqërinë shqiptare. Sipas sociologëve, në krimin në familje kanë ndikuar një sërë faktorësh si ato ekonomiko-shoqërorë, kushtet e banimit, papunësia dhe emigracioni. Gjatë këtij viti gjykatat trajtuan 2100 çështje penale, nga të cilat mbi 1/3 janë për dhunë ndaj grave.



HOROSKOPI

DASHI
 Pozicioni i Hënës në lidhje me Neptunin në shenjinë tuaj do të bëjë t'ju vijin ide nga më të çuditshmet. Do ta kaloni ditën me kokën mbi re. Nuk do të jetë e thjeshtë të harmonizoni ndjeshmërinë tuaj me atë që keni afër, por qartësisht duhet bërë.

DEMI
 Me Jupiterin tek qielli i Peshores mike, parashikohen përmirësime ekonomike. Do të njihni persona të rëndësishëm, tek të cilët do të lini përshlytje të mira. Në dashuri do të tregoni iniciativë, të aftë për t'i bërë të qartë me bindje partnerit ndjenjat dhe dëshirat.

BINJAKET
 Një Hënë e favorshme nga Demi, është e përsosur për profesionin. Nëse ka pastaj një dashuri të re që po gallet, mos humbi kohë dhe bëjeni të ditur. Mos u shqetësoni më për çështje që kanë të bëjnë me paraqitjen. Përqendrohuni në substancë, tek ekuilibri midis të qenit dhe të pasurit.

GAFORJA
 Nëse jeni beqarë, me ndikimin e Uranit, një stazh pune dhe një lundrim në internet mund të të sjellë një risi të këndshme! Me Saturnin tek shenja juaj, ndoshta do të jeni më i varur se zakonisht për aprovimin nga personat e dashur.

LUANI
 Përballni me përditshmërinë me shumë qetësi. Gjëra të reja të vogla dhe gëzime të vogla ju presin dhe do të ishte më mirë të fillonit të mësonit të përfitonit nga këto. Ndërgjegjësimi për atë që është me të vërtetë e rëndësishme do t'ju ndihmonte të kaloni disa zëna me personin e dashur.

VRIGJERESHA
 Me Venusin, Marsin dhe Uranin kundër paralajmërojnë një ngritje të menjëhershme tensionesh, si edhe ndonjë vendim që mund të merret në mënyrë të pakontrolluar. Nguliteni mirë në mendje se gjaknxehtësia dhe paragjykimet mund të ndikojnë që të bëni më shumë sesa një gabim.

PESHORJA
 Hëna tek Demi e lehtëson tensionin e krijuar nga pozicionimi i Saturnit, që vazhdon të ketë kërkesa të ashpra dhe angazhuese. Merrni frymë. Me Neptunin që ju kundërshton mund të zhytëni në dalligë dyshimesh. Mungesë rezultatesh.

AKREPI
 Venusi, Marsi dhe Urani po bëjnë gjithçka, nëse jeni beqarë, për t'ju mundësuar kënaqësi në sektorin sentimental. Gjithçka shkon vaj. Pozicionimi i Saturnit është garanci si gjithmonë se gjërat do të zgjasin dhe do të jenë konkrete.


SHIGJETARI
 Do t'ju duhet të përballemi me ndonjë të papritur dhe nuk do të keni atë elasticitet që do të ishte nevojshëm për t'u përbalur me risi dhe për të riorganizuar programin. Kjo mënyrë e vazhdueshme për të pyetur të jetërt ndoshta fshihet pasqerësinë për paruar atë çka është e ndryshme nga ju.

BRICJAPI
 Me Venusin dhe Uranin që janë në harmoni, priten mbi të gjitha nëse jeni beqarë, perspektiva interesante risish në sektorin e dashurisë. Do të rrethoheni nga njerëz me të cilët ndihen mirë dhe do të mënjani ata që duan t'ju detyrojnë zgjedhjet edhe mendimet e tyre.

UJORI
 Me Hënën që i buzëqesh Neptunit, do të jeni më të ndjeshëm ndaj humorit të personave që ju rrethojnë. Zgjidhni me kujdes se me kë shoqëroheni. Do të keni mundësi për të shprehur konkretisht altruizmin dhe të ndihmoni kush është në vështirësi.

PESHQIT
 Nga pasditja Venusi do të fillojë kalimin të qiellit juaj dhe do të dini të keni përkushtimin e nevojshëm në gjirin e familjes. Do të përqendroni te gjërat e bukura që ju rrethojnë, më shumë se tek ato që janë të kritikueshme.

Fjalëkryqi (1)




HORIZONTAL

- Janë luftarake me kung fu.
- Është me helm ajo e agjentëve.
- Skuadra merengue.
- Fillojnë tatëpjetën.
- Ed aktor.
- Një pjesë... orkestrale.
- Një iranian i dikurshëm.
- Janë tek në kanape.
- I bën kush ha bukë.
- Fundi i një fundi.
- Fillojnë aksionin.
- Janë zeshkanë.
- Shumë zëra në këngë.
- Gjysmë turneu.
- Është grykësi.
- Rastisin në krye.
- Sikur ke thënë çdonjerin.
- Janë vite.
- Angot e Lecocq.
- Ende është ndryshe.
- Kush bën... ve në lojë.

- VERTIKAL**
- Janë kundërmuese.
 - Vreni pa kufij.
 - Kush nuk ka... nuk di të sillet.
 - Artikull spanjoll.
 - Është krimb për grep.
 - Mbyllin një krah.
 - Edouard piktor.
 - Fillojnë profesionin.
 - Turke pa kufij.
 - Ishte Gjermania e Honecker
 - Janë më shumë se dëshira.
 - Janë ujërat në llixha.
 - Bëhet me kandar.
 - I dëgjo vetëm Odiseu.
 - Fillojnë hetimin.
 - Një qendër.
 - Është vjedhje.
 - Makashi këngëtar.
 - Me Alfa në makinë.
 - Loriku te Sunderland.
 - Një pjesë e momenteve.
 - Gjysmë tatimi.
 - Janë legjenda.
 - Nget edhe ajo e mirë.
 - Myslymi i paharruar i futbollit.
 - Ki Moon i OKB.
 - Fleming që krijoi James Bond.
 - Fillojnë hapur
 - Mbyllin komentin.
 - Fillojnë sefte.
 - Fillojnë masat.

Fjalëkryqi (2)



HORIZONTAL

- Është kombëtare me minoritetin.
- Janë godinat e banimit.
- Van Nistelrooy bomber.
- Është e e pas Krishtit.
- Një fjalë para kohe.
- Organizma Tregare Lokale.
- Rripi pa zë.
- Filoko aktor
- Volumi i shkurtër.
- Është diletant.
- Kufizojnë pozicionin.
- Është X ajo e sulmit.
- Ishin shoqëruarit e Panit.
- Kufizojnë katete.
- Janë çupa.
- Bartok kompozitor.
- Tri të parat në atletikë.
- Tekat pa kufij.
- Një pemë.
- Skuadër greke.
- Ishte lumi i harresës.
- Është për medaljen e parë.
- Një fjalë që tregon ritmin.
- Kolegji i famshëm anglez.
- Janë pesë të tillë olimpikë.
- Janë zengjinë.
- Kishte 100 porta.
- Një pjesë e masakrës.
- Mbarojnë fare.
- Janë toka edhe sportive.
- Stoker që shkroi Dracula.
- Është byreck.
- Hapur pa kufij.
- Pal latinisht.
- Rraçe pa re
- Film i famshëm me Brad Pitt dhe Kevin Spacey.
- Qyteti i përjetshëm.
- Një jepet për hartim.
- Jessica aktore.
- Cruise aktor
- Janë në kupë.

VERTIKAL

- Janë shkaktarë shërrri.
- Kanë bërë vepra.
- Është shtëpi me frëngji.
- Fillimi i ideologjisë.
- Iniciale e Einstein.
- Janë gazetat si RD.
- Lodh në kufij.

Gjeni ndryshimin

Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra

Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		2				3	4		
9		7	8	1			6		
	6	2	9			7			
7	5				2	1			
8			6		5			3	
		4	3				2	7	
			9		6	8	5		
	3			4	9	6		1	
5	1				8				

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	8	5	2	6	7	9	3	4
9	4	7	8	1	3	2	6	5
3	6	2	9	5	4	7	1	8
7	5	3	4	9	2	1	8	6
8	2	1	6	7	5	4	9	3
6	9	4	3	8	1	5	2	7
4	7	9	1	3	6	8	5	2
2	3	8	5	4	9	6	7	1
5	1	6	7	2	8	3	4	9

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

P	E	T	E	R		P	A	M	O	R	E
A	M	E	N	K		B	A	N	O	R	E
A	R	E	A	M	I	T	A	E	D	E	M
P	T	E	A	N	A	T	E	M	A	T	E
K	E	T	E	L	E	P	A	T	I		
E	K	O	N	O	M	I	K	E	R	E	S
K	E	N	E	T	A		R	O	B	E	R
E	M	R	E	T	A		R	O	M	B	I
S	I	N	G	E	R	E	T	I	N	A	T
S	A	J	D	I	T	E	R	I	E	M	O
S	H	I	N	E	N	E	M	I	R		
D	A	M	A	R	I	A	K	T	E	T	E

FJALËKRYQI (2)

S	P	O	T		P	B	A	A	L	F	A
A	S	O	P	E	R	E	T	A	T	A	S
U	O	P	E	R	A	T	D	O	R	A	
L	I	P	L	I	P	O	T	I	M	I	A
M	O	N	O	T	O	N	I	I	R	O	N
L	I	Z	T	O	R	T	L	E	O	N	
A	T	I	A	N	T	E	U	E	N	I	S
D	I	A	N	E	T	I	A	L	G	A	T
A	E	I	R	I	S	A	A	R	E	N	E
S	T	O	L	I	K	U	R	A	T	A	R
P	M	A	K	E	T	E	L	E	H	T	E

Argëtim filozofik

MJESHTRI MAGJIK, DA VINÇI

- Nuk ke pushtet më të madh apo më të vogël se ai mbi veten.
- Thjeshtësia është sofistikimi më i mirë.
- Të mësuarit nuk e lodh kurrë mendjen.
- Kur përjeton shijen e fluturimit, do ecësh në tokë me sytë nga qielli, atje ke qenë dhe atje do përpiqesh të kthehesh.
- Një ditë e shpenzuar mirë, sjell gjumë lumturie.

KRIPTOSKEME

2	14	2	7	4	3	9	7	19	3	6
4	2	3	3	2	8	9	7	6	8	4
9	I	R	E	M	A		17	1	8	9
7	10		18	9	7	4	9	5	6	4
6		5	4	3	3	2	12	9	4	2
		5	2	4	2	1	3	9	4	2
3	1	5	6	8	4	9	7	2	4	12
2	8	2		15	6	4	4	7	1	15
16	9	16		2	14	6	9	1	8	2
2	4	2	3		1	14	6		12	6
4	1		2	6		17	6	4	6	14
6	3	7	9	18	6	4		15	6	7

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

D	R	I	T	A	R	E	T	B	O	T	E
O	R	A	P	F	B	E	L	A	T		
B	I	K	O	L	O	N	E	L	B	I	
I	F	I	T	O	R	E	T	T	E	K	
H	K	O	M	E	N	T	E	L	E		
H	A	R	E	M	E	R	E	R	A	T	
T	A	M	A	M	A	S	R	A			
S	A	E	D	S	T	I					
D	T	E	K	S	T	M	I	T	E	T	
E	H	R	R	I	K	I	L	O	N	I	
M	I	R	I	A	M	K	R	E	R	E	T
I	T	A	P	I	N	A	T	I	O		

- Ka njerëz, mospërfillja dhe përbuzja e të cilëve të bën më tepër nder se sa miqësia dhe lëvdatat e tyre. **{Oksenshijorna}**
- Nga mënyra e të qeshurit unë kuptoj se çfarë edukate ka një njeri, ndërsa nga arsyeja e të qeshurit kuptoj inteligjencën e tij. **Rumiu**
- Ne nuk jetojmë, thjesht shpresojmë të jetojmë, duke pritur gjithnjë lumturinë në të ardhmen, ndaj është e pamshangshme që s'do të jemi asnjëherë të lumtur. **(Blez Paskal)**

Thënie të mençura

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

